



Nafta pa akcizë, procesi përfundon në fund të dhjetorit

Faqe 2



Nxitja e ekosistemit të inovacionit në Shqipëri, bizneset aplikojnë për grante deri më 22 dhjetor

Faqe 3



Modele që frymëzojnë, fermeri 35-vjeçar nuk braktis vendlindjen, por investon në bujqësi

Faqe 4



AGROBIZNESI



Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh, Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i parë i muajit dhjetor 2023

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 475
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

ULLIRI DHE CILËSIA E VAJIT TË ULLIRIT NË SHQIPËRI NJËMBËDHJETË ARRESTIME NË SPANJË DHE ITALI PËR VAJ ULLIRI TË FALSIFIKUAR, SEKUESTROHEN 5200 LITRA VAJ DHE 91 MIJË EURO

Për të zgjidhur problemet e vajit të ullirit, që nga shtimi i kapaciteteve grumbulluese, depozituese, paketuese dhe etiketimin e tij, ka nisur zbatimimi i programit "Ulliri dhe cilësia e vajit të ullirit në Shqipëri shtator 2023-2024" nga Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar (KASH) në bashkëpunim me ministrinë dhe subjekte të tjera private dhe publike, financuar nga Projekti RisiAlbania

RISI ALBANIA NJË PROJEKT I AGJENCISË ZVICERANE SDC

**- Këshillimi në karrierë -
Një model shërbimi për të rinjtë në nivel vendor**

RisiAlbania zgjeron shërbimin e këshillimit të karrierës në Elbasan, Lushnje dhe Berat, duke nxitur ndërlidhjen e tregut të punës me arsimin



Qeveria Zvicerane kontribut për zhvillimin rural në Shqipëri



Faqe 2

GRATË NË SIPËRMARRJE

Si mund të arrihet fuqizimi ekonomik i grave?

Faqe 6



KËNDI I MBROJTJES INTELEGJENTE TË BIMËVE



Mbrojtja e integruar e bimëve, strategjia më e suksesshme dhe më afatgjatë

Prof. Ass. Enver Isufi,
Agronom në Mbrojtjen e Bimëve dhe Bujqësinë Biologjike

TEMA TË DITËS

Faqe 12

- **FAO, mbështetje për vlerësimin e dëmeve nga ndryshimet klimatike në sektorët agrourbanë** Fq.10
- **Turizmi në Shkodër, 4 ide zhvillimi i shtohen platformës TIP** Fq.7
- **Destinacion turistik, shtegu që lidh malet mes Shqipërisë, Kosovës e Maqedonisë** Fq.7
- **Arsimi profesional, Gega për ATSH-në: Rreth 60 % e nxënësve punësohen që në vitin e dytë, pagat në turizëm e IT mbi 1000 euro** Fq.6

Ministrja Denaj, takim me homologun nga Kosova: Bashkëpunim për rritjen e shkëmbimeve tregtare



Faqe 2

TEMË E DITËS

Banka Botërore: Katër sfidat më të mëdha për bujqësinë e qëndrueshme në Ballkanin Perëndimor



Faqe 10

RISI ALBANIA

PARTNERITET

Këshillimi në karrierë - Një model shërbimi për të rinjtë në nivel vendor

RisiAlbania zgjeron shërbimin e këshillimit të karrierës në Elbasan, Lushnje dhe Berat, duke nxitur ndërlidhjen e tregut të punës me arsimin

Stafi vendor i bashkive në Elbasan, Lushnje dhe Berat tashmë është i aftë për shërbimet e këshillimit të karrierës!

Ja disa nga opinionet e të rinjve si dëshmi për të parë se si ata janë të përgatitur për tu fuqizuar dhe pritshmëritë për t'u rritur profesionalisht në tregun e punës.

(Vijon në faqen 4)

Samiti i Klimës COP 28, Rama: Shqipëria, një prej vendeve të rralla që s'ka emetime të dioksidit të karbonit nga prodhimi i energjisë

Kryeministri Edi Rama mori pjesë në Samitin Botëror të Veprimit për Klimën COP 28, i cili zhvillohet çdo vit, si një takim mes liderëve të shteteve dhe qeverive për të përcaktuar përgjegjësitë për veprimin ndaj klimës dhe për të identifikuar dhe vlerësuar masat klimatike.

Në ditën e dytë të Samitit, i cili këtë vit po mbahet në Emira-

premtim i bërë nga bota për të ruajtur planetin tonë dhe banorët e tij, e megjithatë realiteti është larg zotimeve të ndërmarra. Për ta thënë ashtu siç është, barra e aksionit për klimën vazhdon të bjerë në mënyrë shpërpjesëtimore në shtatullat e vendeve në zhvillim, pavarësisht kontributit tonë minimal në këtë krizë ndërkohë që ndotësit e mëdhenj

“Sigurisht nga ana tjetër, përballet me një rrezik ekstrem hidrologjik sepse ne varem nga klima edhe pse tashmë jemi në një diversifikim në shkallë të plotë me energjinë e erës dhe diellit. Së treti, Shqipëria ka ecur përpara me zbatimin e praktikave të zgjidhjeve bazuar në natyrë gjatë viteve të fundit dhe këtë vit Vjosa, i pagëzuar lum i fundit i egër i Europës është shpallur Park Kombëtar në Shqipëri. Ishte për të qeshur sidoqoftë, sepse më të mëdhenjtë e më të pasurit rreth nesh në Europë, që kanë zbutur të gjithë lumenjtë e tyre na dhanë leksione gjatë gjithë kohës se sa e rëndësishme ishte të kishim një lumë të egër në Europë, por s'ka rëndësi, të qeshësh është mirë dhe angazhimi ynë është i fortë dhe real ndaj ne e bëmë dhe jemi plotësisht të përkushtuar që të vazhdojmë kështu”, theksoi Rama.

Kryeministri Rama u shpreh se “në fund më lini ta përmbyll me një përmendje të veçantë e të falenderoj nga zemra vendin mikpritës të kësaj ngjarjeje të madhe, Emiratat e Bashkuara Arabe dhe udhëheqjen e këtij vendi, Presidentin vizionar Mohammed bin Zayed i cili po i tregon bashkësisë sonë të vendeve çfarë do të thotë të lidhësh fjalët me veprat dhe duke iu thënë mirupafshim të gjithëve, uroj të kishim pasur më shumë Emirate të Bashkuara Arabe në komunitetin tonë të vendeve në mënyrë që atë çfarë është e zymtë, ta bëjmë më të lehtë e rugëtimin tonë më të ndritshëm”.

et e Bashkuara Arabe, Kryeministri Edi Rama në fjalën e tij tha se “si përfaqësues i Republikës së Shqipërisë, por edhe i një rajoni që po ecën shpejt, por është ende në zhvillim në Europë, i quajtur Ballkani Perëndimor, qëndroj këtu para jush sot për të ndarë disa mendime. Të gjithë e dimë se për dekada vende në zhvillim si i yni, janë rrekur në mënyrë të palodhur për të trajtuar sfida të zhvillimit ndërkohë që janë përballur me efektet negative të ndryshimit të klimës”.

“Dhe po, marrëveshja e Parisit ishte një rreze shprese, një

bëjnë maksimumin e tyre për të na dhënë leksione, por jo për t'u ndalur vetë. Megjithatë ajo çfarë ne bëjmë, është ajo tek e cila besojmë dhe jemi zotuar të ulim emetimet e gazrave serrë në nivel global me 20.9% deri në 2030 dhe të arrijmë asnjë-nësinë klimatike deri në 2050”, nënvizoi Rama.

Së dyti, vijoi Rama, vendi ynë synon të bëhet lider energjetik në rajon dhe eksportues neto energjie deri në 2030, por duhet ta dini që Shqipëria është një prej vendeve të rralla që nuk ka emetime të dioksidit të karbonit nga prodhimi i energjisë.

do të vlerësojë progresin në Marrëveshjen e Parisit – traktatin historik të klimës i nënshkruar në 2015 – dhe do të përcaktojë një kurs veprimi për të reduktuar në mënyrë dramatike emetimet dhe për të mbrojtur jetët dhe mjetet e jetesës.

Shkenca është e qartë: për të ruajtur një klimë të jetueshme, prodhimi i qymyrit, naftës dhe gazit duhet të bjerë me shpejtësi dhe kapaciteti global i energjisë së rinovueshme – duke

përfshirë energjinë e erës, diellore, hidro dhe gjeotermale – duhet të trefishohet deri në vitin 2030. Në të njëjtën kohë, financimi për përshtatjen dhe investimet në qëndrueshmërinë klimatike kanë nevojë për një kërcim kuantik.

COP28 bashkon udhëheqës nga qeveritë, bizneset, OJQ-të dhe shoqëria civile për të gjetur zgjidhje konkrete për çështjen përcaktuese të kohës sonë.

Ministrja Denaj, takim me homologun nga Kosova: Bashkëpunim për rritjen e shkëmbimeve tregtare

Ministrja Denaj, takim me homologun nga Kosova: Bashkëpunim për rritjen e shkëmbimeve tregtare të produkteve bujqësore dhe blektorale

Ministrja e Bujqësisë dhe

në fushën e bujqësisë, rritjen e shkëmbimeve tregtare sidomos produkteve bujqësore e blektorale.

“Diskutimet i përqendruam në shkëmbimin e përvojave,

për të dy vendet në fushën e bujqësisë”, u shpreh ministrja Denaj.

Gjatë këtij takimi u vendosën disa piketa bashkëpunimi konkrete në aspekte bilaterale të grupeve teknike të punës, në mënyrë që të arrihet kursimi i kohës dhe kostove.

Denaj u shpreh se Kosova ka një rritje të vlerësimit në raport me sistemin e regjistrimit të tokës (FADN) që ne në Shqipëri jemi duke punuar dhe do të marrim një eksperiencë shumë të mirë e cila do të ndihmojë të projektohet siç duhet, duke shmanjur disa gabime që mund të kenë bërë më parë kolegë tanë në Kosovë.

Për më tepër u theksua vijimi i bashkëpunimit dypalësh në fushën e agroturizmit, ku paketat e përbashkëta turistike do të jenë jo vetëm për shqiptarët dhe bashkëkombasit tanë në Kosovë, por edhe për turistët e huaj.



Zhvillimit Rural, Anila Denaj u takua me ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Kosovës, Faton Peci.

Gjatë takimit të mbajtur në Tiranë, palët theksuan bashkëpunimin mes dy vendeve

teknologjive moderne dhe strategjive, për të përmirësuar prodhimin bujqësor në të dy vendet dhe sigurinë ushqimore të produkteve, duke synuar të krijojmë një bashkëpunim të qëndrueshëm dhe në avantazh

Nafta pa akcizë, procesi përfundon në fund të dhjetorit

Të gjithë fermerët që kanë aplikuar për të përfituar naftën pa akcizë do të marrin sasinë në bazë të sipërfaqeve që zotërojnë.

Drejtori i Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor në Korçë, Vullnet Gjolla ka bërë me dije se deri në fund të muajit dhjetor fermerët duhet ta tërheqin sasinë e naftës. Këtu përfshihen fermerët potencialë dhe superpotencialë që nuk e kanë tërhequr të gjithë sasinë për të cilën kanë aplikuar. "Sapo ne ti njoftojmë fermerët duhet të vijnë të marrin naftën" tha zoti Gjolla.

Në qarkun e Korçës kanë



aplikuar në skemën e naftës 10 750 fermerë, nga të cilët kanë përfituar rreth 7500, ose rreth

70% e tyre. Pjesa tjetër do të marrë kartat e naftës pa akcizë deri në fund të dhjetorit.

Vizioni 2030, UBT partneritet me Universitetin prestigjioz vjenez, BOKU

Universiteti i Burimeve Natyrore dhe Shkencave të Jetës, Vjenë (BOKU) është tashmë një partner strategjik i Universitetit Bujqësor të Tiranës që do të shërbejë si një model orientues për objektivat, veçanërisht në drejtim të ndërkombëtarizimit të strukturave dhe ofertës akademike.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj dhe rektori i Universitetit Bujqësor të Tiranës, Fatbardh Sallaku, zhvilluan një takim të rëndësishëm me Prof. Eva Schulev-Steindl,

rektore e Universitetit BOKU, në Vjenë, ku diskutuan modalitetet dhe hapat e fundit para firmosjes së projektit të bashkëpunimit BOKU-UBT 2030.

Denaj tha se, gjatë takimit u diskutua rreth zhvillimeve të tregut të punës dhe përpjekjes së universiteteve, por edhe politikkëmbësve për t'i ofruar të rinjve në Shqipëri diploma me vlerë për punësim sipas nevojave që diktojnë tregjet globale.

Pjesë e bisedimeve ishin edhe mundësitë për financim të projekteve inovative dhe trans-

ferim të njohurive për avancimin e sektorit bujqësor në Shqipëri, si dhe rëndësinë e kërkimit shkencor në avancimin e zhvillimit të qëndrueshëm rural në vend”.

Danja tha se, “nëpërmjet implementimit 4-vjeçar të këtij projekti, synohet reformimi i thellë i UBT-së, në mënyrë që të përafrohet brenda vitit 2030 me BOKU dhe universitetet homologe europiane në të tre kolonat e misionit të tij: programet e studimit, kërkimin shkencor dhe transferimin e njohurive”.

COP28: Veprimi për klimën nuk mund të presë

Me temperaturat globale që arrijnë nivele rekord dhe ngjarjet ekstreme të motit që prekin njerëzit anembanë globit, konferenca e këtij viti e OKB-së për ndryshimet klimatike, Sesiioni 28 i Konferencës së OKB për klimën - Konferenca e Palëve (COP28), është një mundësi thelbësore për të korigjuar kursin dhe për të përshtatur veprimet për të trajtuar krizën klimatike.

COP28 është vendi ku bota

STANDE SIPAS BE-SË

ULLIRI DHE CILËSIA E VAJIT TË ULLIRIT NË SHQIPËRI

NJËMBËDHJETË ARRESTIME NË SPANJË DHE ITALI PËR VAJ ULLIRI TË FALSIFIKUAR, SEKUESTROHEN 5200 LITRA VAJ DHE 91 MIJË EURO

Për të zgjidhur problemet e vajit të ullirit, që nga shtimi i kapaciteteve grumbulluese, depozituese, paketuese dhe etiketimin e tij, ka nisur zbatimin e programit "Ulliri dhe cilësia e vajit të ullirit në Shqipëri shtator 2023-2024" nga Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar (KASH) në bashkëpunim me ministrinë dhe subjekte të tjera private dhe publike, financuar nga Projekti RisiAlbania

Njëmbëdhjetë persona janë arrestuar në një operacion në Itali dhe Spanjë, pasi dyshohet që vaji që shisnin ishte i përzier me produkte të palejuara për konsum.

Garda Civile dhe Karabinierët sekuestruan në tërësi rreth 5200 litra vaj ulliri të falsifikuar, të gatshëm për shitje për publikun, 91 mijë euro cash dhe katër automjete.

Operacioni ka prekur provincat e Ciudad Real dhe Jaén, provinca të cilat shquhen për prodhimin në masë të vajit të ullirit.

Operacioni filloi pasi Seprena (policia ekologjike e Gardës Civile) zbuloi parregullsi në vajin e ullirit të transportuar nga një kamion cisternë që u inspektua në qytetin Manzanares (Ciudad Real).

Ajo që ata panë është se ky produkt ishte në kufirin e cilësisë minimale për të qenë i virgjër ose ekstra i virgjër (cilësia më e lartë).

Sipas autoriteteve ata përdorën të ashtuquajturat vajra lampante, cilësia më e keqe, për shkak të aciditetit të lartë dhe erës dhe aromës së pakëndshme, tregtimi i të cilave është i ndaluar.

Sipas hetuesve, të arrestuarit përzienin një masë cilësore të vajit me një masë vaji jashtë parametrevë.

Gjatë hetimeve janë kryer 8 kontrolle njëkohësisht në

Spanjë dhe Itali, të cilat kanë konkluduar me arrestimin e 11 personave.

Pesë nga inspektimet kanë ndodhur në fabrikat e mbushjes së naftës dhe magazinat në provincat e Ciudad Real, Jaén dhe Córdoba.

Rënia e prodhimit të ullirit këtë vit, sipas Ministrisë së Bujqësisë, u ndikua nga dukuria e periodicitetit e njohur për kulturën e ullirit dhe kushtet klimatike. Por hapja e tregut të eksportit për vajin e ullirit vitin e kaluar dhe kontratat e lidhura edhe për këtë vit që prodhimi është i ulët, do të sjellë një rritje të konsiderueshme të çmimit të vajit të ullirit, nënvizon Ministria e Bujqësisë për "Monitor".

Zgjidhja si në rast mbiprodhimi dhe nënprodhimi sipas Ministrisë së Bujqësisë duhet të nisë që nga investimet në mekanizimin e punimit dhe vjeljes së ullirit, ruajtjen dhe prodhimin me cilësi të vajit duke rritur numrin fabrikave dhe përpunuesve që bëjnë grumbullimin e vajit nga prodhuesit e vegjël.

Për të zgjidhur problemet e vajit të ullirit, që nga shtimi i kapaciteteve grumbulluese, depozituese, paketuese dhe etiketimin e tij, ka nisur zbatimin e programit "Ulliri dhe cilësia e vajit të ullirit në Shqipëri shtator 2023-2024" nga Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar (KASH) në bashkëpunim me ministrinë

dhe subjekte të tjera private dhe publike, financuar nga Projekti RisiAlbania që fillimisht ka nisur me ofrimin e asistencës për fermerët për bashkimin e ngastrave, mekanizimin e ullishtave për të vijuar më tej me disbursim të fondeve grand si dhe përmirësim të shumë akteve nënligjore.

Sa ton vaji ulliri u prodhuar në vitin 2021 dhe në vitin 2022? Sa ton vaji parashikohet për 2023?

Për vitin 2021 u prodhuar 25,882 tonë vaj ulliri. Për vitin 2022, prodhimi i vajit të ullirit ishte 29,230 tonë (rritja 13%). Lidhur me situatën e prodhimit është ende herët për të përcaktuar sasinë e prodhuar të vajit të ullirit për vitin 2023 duke qenë se nuk është vjelë e gjithë sasia e ullinjve.

Vjet pati mbiprodhim, por s'pati treg shitje, vaji nga fermeri u shit nën kosto. Së pari, pse këtë vit ka rënë prodhimi i vajit të ullirit? Si pritet të zgjidhet kjo problematikë e sektorit, pra si mbiprodhimi dhe kur ka prodhim të ulët?

Prodhimi periodik është dukuri e njohur tek ulliri, si dhe ngarkesa e lartë e prodhimit në vitin e kaluar, ka ndikuar në uljen e prodhimit gjatë këtij viti. Ulliri ashtu si kulturat e tjera shumëvjeçare drufrutore, mbart fenomenin e njohur si

"prodhim të alternuar të prodhimit", ku një vit me prodhim të bollshëm (i quajtur "viti me ngarkesë") pasohet nga një vit me prodhim të dobët (të quajtur "vit pa ngarkesë").

Në një ullishte luhatjet e prodhimit nga njëri vit në tjetrin deri në kufijtë e 30% konsiderohet normale.

Në kushtet e vendit tonë me gjendjen e ullishtave dhe me shërbimet që kryhen, në përgjithësi nga një analizë e bërë për shumë vite ka rezultuar me rezultate mjaft të theksuara të sezonalitetit.

Kushtet klimatike, lagështia e tepërt në kohën e lulëzimit ka ndikuar në procesin e lidhjes së frutave. Po ashtu, thatësira e tezgjatur gjatë periudhës së verës, ka ndikuar në rrëzimin e frutave dhe rritjen e madhësisë së frutës, pasi një pjesë e mirë e sipërfaqes së ullishtave janë mbjellë në toka kodrinore pa mundësi ujitje.

Hapja e eksportit për vajin e ullirit vitin e kaluar dhe kontratat e lidhura edhe për këtë vit që prodhimi është i ulët do të sjellë një rritje të konsiderueshme të çmimit të vajit të ullirit.

Luhatshmëria e prodhimit nga njëri vit në tjetrin vjen edhe për shkak të copëzimit të madh të ngastrave të ullirit, që e bën prodhimin jo efikas. Për të ulur disnivelet e prodhimit të ullirit duhet të mbillen va-

rietete me periodicitet të ulët. Gjithashtu rekomandohet të zgjidhen problemet në nivel ferme si, teknologjitë jo të përparuara dhe pamjaftueshmëria e investimeve në ullishte nga vetë fermerët.

Në rast mbiprodhimi, zgjidhja është investimi në mekanizimin e vajit të ullirit, në ruajtjen e tij që të mos humbasë vlerat, në përmirësimin e marketingut, ndërtimin e fabrikave me teknologji të përparuar që prodhojnë vajra të cilësisë së lartë, gjithashtu në rritjen e numrit të përpunuesve që bëjnë grumbullimin e vajit nga prodhuesit e vegjël, por edhe nga përpunues që kanë kapacitete më të ulëta grumbullimi.

Përgjatë vitit 2023 AKVMB Në kuadër të Planit të Monitorimit të Dëmtuesve për Vitin 2023, ka monitoruar problematikën fitosanitare të bimës së ullirit Oleae europeae, kryesisht për dëmtuesin karantinor Xylella fastidiosa dhe dëmtuesin jokarantinor të rregulluar DJKRr Bactrocera oleae

Për bimën e ullirit janë marrë 347 mostra për analizim pranë laboratorit të mbrojtjes së bimëve të ISUV si bima bujtëse kryesore me interes ekonomik që preket nga X. fastidiosa. Mostrat për bimën e ullirit (Olea europaea) u morën si në pemëtoret e kultivuar në blloqe dhe në ato të shpërndara.

Nga Raport-Pravat e prod-

huara nga ISUV dhe të administruara nga AKVMB rezultojnë që në asnjë nga mostrat nuk ka prani të X. fastidiosa (Wells et al.). Në Shqipëri nuk kemi prani të këtij dëmtuesi karantinor.

Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB), në bashkëpunim me QTTB Vlorë ka koordinuar punën për detajimin e monitorimit e vazhdueshëm dhe marrjen e mostrave nga kultura e ullirit.

Miza e ullirit Bactrocera oleae (Rossi) është një dëmtues monofag i listuar si dëmtuesi kryesor i ullirit duke shkaktuar në vite të caktuara dëm në prodhim me pasoja të rëndësishme ekonomike. Nga monitorimi dhe analizimi i mostrave të kokrave të ullirit të kampionuar ka rezultuar:

Në kushtet atmosferike të këtij viti, temperaturat e larta dhe lagështia e ulët ajrore kanë ndikuar, që infeksioni në kokrrën e ullirit nga larvat e B. oleae (Rossi) të jetë në nivele të ulëta. Ulja e temperaturave dhe ditët me vranësira, kanë sjellë shtim të numrit të mizave të kapura në kurthe.

Niveli maksimal i infeksionit nga miza e ullirit është arritur në datë 21 shtator. Për sa më sipër, konkludojmë që problematikën fitosanitare nuk kanë shërbyer si faktorë të rënies së nivelit të prodhimit të ullirit për vitin 2023

AKSES NË FINANCIM

Nxitja e ekosistemit të inovacionit në Shqipëri, bizneset aplikojnë për grante deri më 22 dhjetor

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar dhe AIDA informojnë të gjithë palët e interesuara mbi skemat e reja financiare, në kuadër të mbështetjes së ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme.

Në platformën "Akses në Financë" mund të gjeni thirrjen më të re të publikuar: EU4INNOVATION Challenge Fund – First Call for Proposals.

Për t'u njohur me thirrjen, kushtet e pranimit, masën e financimit dhe më shumë, vizitoni platformën në linkun: <https://aida-smefinance.gov.al/financial-schemes/eu4innovation-challenge-fund-thirrja-e-pare-per-propozim>.

Përshkrim

The Challenge Fund është skema e granteve të projektit EU4Innovation, Faza II, 2023-2026 në mbështetje të start-up-ëve inovative. Objektivi i këtij fondi është të nxisë ekosistemin e inovacionit në Shqipëri, duke ofruar një mundësi për akses në financë për start-up-et shq-

iptare nëpërmjet një procesi aplikimi të hapur, transparent dhe konkurrues. Ky grant do të shërbejë për të kapërcyer pasigurinë që pengojnë inovacionin, kërkimin dhe zhvillimin pa të cilin supozohet se aktivitetet të tilla ose nuk ka gjasa të ndodhin, ose do të ndodhin në një fazë të mëvonshme, me efekte të reduktuara zhvillimore. Fondi menaxhohet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (SIDA) dhe zbatohet në bashkëpunim me Partners Albania for Change and Development.

Fondi është i hapur për start-up-et e krijuara rreth koncepteve inovatore të biznesit, të regjistruara ose që do të regjistrohen dhe operojnë në Shqipëri. Aplikimet pranohen vetëm në gjuhën angleze për

të lejuar një proces transparent përzgjedhjeje.

Përkufizimet

• Start-ups janë individë dhe persona fizikë ose juridikë, të cilët janë konceptuar, krijuar dhe operojnë, deri në 5 vjet, me qëllim fillimin e realizimit dhe zhvillimit të një modeli biznesi, produkti teknologjik inovativ dhe/ose të veçantë; shërbime me potencial rritjeje të shpejtë, për përmirësimin e ndjeshëm të modeleve të biznesit, produkteve dhe shërbimeve ekzistuese.

• Inovacioni përkufizohet si "zbatim i një produkti të ri ose të përmirësuar ndjeshëm (mall ose shërbim), ose proces, një metodë të re marketingu, ose një metodë të re organizative në praktikën e biznesit, organizimin e vendit të punës ose mar-

rëdhëniet me jashtë (OECD).

The Challenge Fund është i hapur për tre nënkategori të bizneseve fillestare:

• Loti 1: Fillesat e fazës së idesë dhe vlefshmërisë, d.m.th. një themelues ose një ekip në fazat e hershme të zhvillimit të një ideje biznesi inovatore (e paregjistruar në QKB).

• Loti 2: Fillesat në fazën e rritjes, pra një subjekt biznesi i regjistruar (MSME1) brenda 12 muajve të parë të funksionimit (nga regjistrimi zyrtar i subjektit afarist në QKB deri në datën e publikimit të Thirrjes për Propozime).

• Loti 3: Nisjet në fazën e shkallëzimit, një subjekt biznesi i regjistruar (MSME) brenda 13 muajve të parë deri në 5 vitet e funksionimit (nga regjistrimi zyrtar i subjektit afarist në QKB deri në datën e publikimit

të Thirrjes për Propozime).

Objektivat

- The Challenge Fund synon të nxisë krijimin e start-up-ëve dhe të lehtësojë rritjen e tyre. Çdo start-up është unik dhe ka nevoja unike për sa i përket alokimit të fondeve. Fondet nga The Challenge Fund mund të përdoren për një sërë aktivitetesh, për sa kohë që këto konsiderohen të arsyeshme dhe në përputhje me objektivin e propozimit të biznesit.

Pranueshmëria

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme të përshtatshmërisë për t'u kualifikuar për një grant sipas The Challenge Fund:

• të jetë person juridik (entiteti biznesi - NMVM) i krijuar tashmë në Shqipëri (i aplikue-

shëm vetëm për Lotet 2 & 3),

• të sigurojë që startup-i do të regjistrohet si një entitet biznesi - NMVM dhe do të operojë në Shqipëri (i aplikueshëm vetëm për Lotin 1) (prandaj edhe diaspora shqiptare, dhe banorët joshqiptarë në Shqipëri do të kenë të drejtë të aplikojnë për sa kohë që biznesi sigurohet se do të zhvillohet në Shqipëri);

• Të mos ketë kryer aktivitet të regjistruar për më shumë se 5 vjet nga data e publikimit të kësaj Thirrjeje për Propozime;

• Duhet të sigurojë një pjesë minimale të bashkëfinancimit të vlerës totale të buxhetit të propozuar, në përqindjen përkatëse, siç parashikohet në seksionin 4.2. të Dokumentit të Udhëzimit;

• Nuk ka detyrime për pagesën e taksave ndaj autoriteteve kombëtare dhe lokale (e aplikueshme vetëm për Lotin 2 dhe 3);

• Të jetë drejtpërdrejt përgjegjës për përgatitjen dhe zbatimin e aktiviteteve të përkrahura në aplikacion.

Të rinjtë në sipërmarrje, Anjeza Zmakaj model për t'u ndjekur

Rubrika "Të rinjtë në sipërmarrje", ka për qëllim të prezantojë histori frymëzuese të rinisë tonë rurale, që i kanë kthyer ëndrrat e tyre në realitet. Falë mbështetjes së projekteve që zbatohen në vendin tonë, me kontributin e çmuar të donatorëve Anjeza Zmakaj nga fshati Xathë, Bashkia Fushë Arrëz ka shndërruar dashurinë e saj për bletët në një sipërmarrje të qëndrueshme, duke mbrojtur këta pjalmues jetikë dhe duke krijuar një biznes në harmoni me natyrën.



"Falë mbështetjes mora gjithçka që më nevojitej për të transformuar pasionin tim në një biznes të mirëfilltë, për mbarëshim bletësh dhe prodhim mjalti. Nga ky projekt i financuar nga Bashkimi Evropian unë përfitova një laborator për prodhimin e ushqimit të bletëve, përpunimin e dyllit dhe mbledhjen e mjaltit. Bletët janë shumë të rëndësishme për mjedisin dhe jetën tonë, unë i konsideroj ato si një familje, sigurohem që janë mirë, i kontrolloj për sëmundje të ndryshme dhe i dërgoj në kullotat më të mira. Të merresh me mbarëshimin e bletëve është një pasion që rritet çdo ditë". – u shpreh ajo.

Para pak muajsh qeveria miratoi ligjin organik të bletarisë, shumë të rëndësishëm dhe të kërkuar prej kohësh nga mbrojtësit e bletës dhe prodhuesit e mjaltit në vendin tonë. Ky është një ligj, i ndërtuar në bashkëpunim të plotë me të

gjitha shoqatat e bletarëve, në përputhje me praktikën më të mira të BE-së, që i përgjigjet problematikave të sektorit.

Ligji vendosi themelin dhe kuadrin e plotë për bletarinë në mjedis, bujqësi, ekonomi dhe krijimin e të ardhurave, duke rregulluar në mënyrë të plotë dhe shteruese të gjithë dinamikën e bletarisë në lidhje me marrëdhëniet me shërbimin veterinar dhe pushtetin vendor, territorin, shtegëtimet e kontrolluara dhe sigurinë e produkteve të bletës, por edhe mbrojtjen e zhvillimin në territor të një specieje të tillë jetike për polenizimin e kryqëzuar dhe biodiversitetin, pra për vijimësinë e jetës.

Përveç rregullimit të sektorit, mbrojtjes së bletës, mbështetjes së drejtpërdrejtë të bletarëve, Qeveria po mbështen edhe përpunuesit e nënprodukteve dhe startup-et që duan të ofrojnë produkte të diversifi-

kuara të shërbimeve kurative, apikulturës, apo apiturizmit, në hapësirën rurale të magjishme shqiptare që mund ta mundësojë zhvillimin e kësaj njeje të rëndësishme ekonomike.

Mbështetja e këtij sektori, përtej efektit pozitiv që ka në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e performancës ekonomike, ka një efekt më të rëndësishëm dhe strategjik në performancën ekonomike të gjithë sektorit bujqësor të vendit.

Kështu p.sh është rasti i regjistrimit të produkteve si specialitet tradicional i garantuar STG për ta çuar në një nivel tjetër promovimin dhe mbrojtjen e produkteve shqiptare të bletëve kudo në botë.

Rubrika "Të rinjtë në sipërmarrje", në gazetën "Agrobiznesi" do të vijoj me raste të tjera, ndaj ftojme lexuesit të na ndjekin për të zbuluar histori të tjera frymëzuese nga të rinjtë e Shqipërisë.

FED Invest apel prodhuesve dhe grumbulluesve të vajit të ullirit: Regjistrohuni në ABA Online, ju ndihmon në rritjen e cilësisë së prodhimit

FED Invest i bën apel të gjithë prodhuesve dhe grumbulluesve të vajit të ullirit, të regjistrohen në ABA Online, pasi aty do të marrin të gjithë asistencën e nevojshme dhe do të ndihmohen në rritjen e cilësisë së prodhimit, që është garanci për tregtim të sigurt.

ABA përmes informimit të detajuar zbuloni sekretet e vlerësimit të cilësisë së vajit të ullirit!

Nga vrojtimi i ngjyrës, tek nuhatja dhe degustimi.

ABA informon aktorët e sektorit të njihen me mënyrën e përcaktimit të aciditetit të vajit me analiza të thjeshta.


Cilat janë standartet e lejuara për aciditetin në Bashkimin Evropian?

Për më shumë ABA fton të interesuarit të shfletojnë fletëpalosjen "Vlerësimi Cilësor i Vajit të Ullirit", përgatitur nga ekspertët e Projektit të përbashkët "Nxitja e eksporteve të Vajit të Ullirit përmes përmirësimit të cilësisë".

Kjo fletëpalosje gjendet në plat-

formën ABA online bit.ly/ABAV2

Regjistrimi në ABA Online ju ndihmon në rritjen e cilësisë së prodhimit,



sigurimin e këshillave nga ekspertët e fushës dhe krijimin e partneriteteve me blerës të mundshëm dhe eksportues, duke hapur rrugën për të eksploruar mundësi të reja tregu.

Mos e humbisni këtë mundësi të jashtëzakonshme! Bëhu pjesë e dritares së vajit të ullirit në vetëm pak minuta! Regjistrohu tani!

bit.ly/ABA-Online, bën të ditur zyra e ABA online.

Modele që frymëzojnë, fermeri 35-vjeçar nuk braktis vendlindjen, por investon në bujqësi

Bujqësia po merr gjithnjë më shumë vëmendjen e të molla. Ai ka mbjellë 2 hektarë tokë dhe siguron të ardhura të

parë se shumë vet u larguan nga vendi mbetem pak fermer që merren me këtë punë kështu që mendoj se prodhimi do të shitet më lehtë", tha fermeri Xhenin Kambo.

Pasi ka studiuar tregun për varietetet që kanë më tepër interes nga konsumatori, si dhe ato që janë më rezistente në kushtet atmosferike të zonës, ai ka vendosur të zëvendësojë kultivarët në një prej pemtoreve.

Fermeri na tregon se ka përfutur edhe nga skemat mbështetëse në bujqësi, duke i dhënë një ndihmesë të madhe në punën e tij. Qarku i Korçës prodhon rreth 80 mijë ton mollë në vit të cilat shiten kryesisht në tregun vendas.



rinjve. I tillë është dhe rasti i fermerit 35-vjeçar nga Devolli, Xhenin Kambo, i cili ka investuar në pemtore me

kënaqshme.

"Kam investuar në rrjeta, në toka të reja gati për tu mbjellë, në agregate bujqësore. Duke

Grupi i grave në Qelëz, Pukë kërkojnë mbështetje për zhvillimin e zonës

Grupi i grave në Qelëz, Pukë kërkojnë mbështetje për zhvillimin e zonës Gratë në zonat rurale kanë kurajo dhe vizion, ndaj kërkojnë mbështetje për zhvillimin e zonës. Grupi i grave në Qelëz, Pukë kanë përgatitur një thirrje ndaj autoriteteve, donatorëve dhe organizatave rurale për mbështetje në ndihmë të zhvillimit të zonës dhe aktivitetit të tyre rural, çka do t'i ndihmojë ato të rrisin angazhimin në punët e bujqësisë, agroturizmit, si dhe

të ardhurat në familjet e tyre.

Përmes një deklaratë publike të nënshkruar me 21 Tetor 2023, në kuadër të aktivitetit "Aromë Fshati" mbi potencialin turistik të zonës së Qelzës, ato kërkojnë mbështetje në projektet që zhvillojnë infrastrukturën rurale në zhvillimin e sektorit turistik si dhe të financohet në krijimin e shtigjeve për bicikleta, të krijohet një info point, me informacion të detajuar për turistët, për operatorët turistik,

bujtinat etj.

Kjo deklaratë vjen si rezultat i aktivitetit që u organizua në formën e tryezës së rrumbullakët ku përfaqësues të pushtetit lokal, të biznesit dhe nga shoqëria civile diskutuan lidhur me sfidat e zhvillimit turistik të zonës dhe mundësitë për bashkëpunim dhe zhvillim të mëtejshëm të fshatit Qelëz. Shoqata Agro-Puka mbështetet nga projekti "Përmirësimi i jetesës së njerëzve në Shqipërinë Verilindore".

(Vijon nga faqja 2)

Alban Shingjergji Bashkia Elbasan

"Ky trajnim është mjaft i vlefshëm për të gjithë ata që ishin të pranishëm. Besoj se mësova mjaftueshëm, nisur që nga modeli i duhur për ndërtimin e një CV-je, letra e motivimit dhe një sërë procesesh të tjera që janë të nevojshme në konkretizimin e këshillimit të karrierës".

Kamela Jaçellari Bashkia Lushnjë


"Falë vizionit të bashkisë Lushnjë, e cila ka në fokus

rininë, lindi nevoja e krijimit të qendrave të këshillimit të karrierës, kjo do të kthehet në një shërbim gjithëpërfshirës për të rinjtë dhe prindërit të cilët do të marrin një informacion më të detajuar për tregun e punës dhe arsimimin e fëmijëve të tyre".

Majlinda Ramaj Bashkia Berat

"E shoh me shumë vlerë pasi kryetari i bashkisë ka pasur një fokus të veçantë të

Këshillimi në karrierë - Një model shërbimi për të rinjtë në nivel vendor



rinjtë dhe u konkretizua me hapjen e një qendre multifunktionale pranë bashkisë Berat dhe një shërbim i shtuar do të ishte dhe këshillimi për karrierën. Ne aplikua për këtë projekt dhe rezultuam fitues. Një falenderim shumë i madh për RisiAlbania-n dhe qeverinë zvicerane, e cila dhe në pushtetin vendor na ofron një mundësi për krijimin e shërbimit të këshillimit të karrierës".

Laureta Isufi Bashkia Tiranë

"Ekziston një zyrë e këshillimit të karrierës edhe në bashkinë Tiranë, që operon që prej vitit 2020, por këtë herë me nxitjen e shërbimit social dhe të Drejtoreshës së Përgjithshme Anisa Subashi, me mbështetje të RisiAlbania dhe qeverisë zvicerane, do të mund ta implementojmë në një mënyrë tjetër në qendrat komunitare, synojmë të shpëtojmetë rinj nga tentativa për të ikur në një vend tjetër duke qenë se i bëjmë të aftë për një treg pune në vendin tonë.

BUJQËSI

Vlorë, Denaj: I rëndësishëm rajonizimi i kulturave drufrutore dhe vreshtave, duke ruajtur resurset autoktone

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj, gjatë një takimi me fermerët e Vlorës, ka nënvizuar angazhimin e qeverisë për t'i mbështetur ata me qëllim arritjen e prodhimit të qëndrueshëm dhe konkurrues në treg.

Me anë të një postimi në rrjetet sociale, Denaj thekson se, gjatë kësaj vizite, ka vëzhguar nga afër mënyrën e këshillimit të fermerëve për mbrojtjen e bimëve dhe vreshtave nga insektet dhe viruset.

"Novoselë. Bashkë me zv/ministrin Kote, Prefektin e Vlorës, Flamur Mamaj, kryetarin Ermal Dredha dhe kolegët deputetë në një vizitë në QTTB Vlorë, ku u njoha nga afër me mënyrën e këshillimit të fermerëve për mbrojtjen e bimëve dhe vreshtave nga insektet dhe viruset", shkruan ministrja Denaj.

Sipas saj, në diskutimin me fermerët e kësaj zone ka vlerësuar punën e përditshme të tyre si kultivarë, duke theksuar se



duhet "rajonizimi i kulturave drufrutore dhe vreshtave, duke ruajtur resurset autoktone është mjaft e rëndësishme për zhvillimin e ekonomive familjare dhe asaj rajonale".

"U përqendruam në përdorimin e teknologjive moderne në kultivimin e ullirit, mbrojtjen nga sëmundjet, dhe zhvillimin

e tregut të produkteve të ullirit. Mbetemi të angazhuar në mbështetjen e fermerëve për të arritur një prodhim më të qëndrueshëm dhe konkurrues në treg", përfundoi Denaj.

Ekonomia Blu, kapital natyror i Shqipërisë, burim punësimi dhe rritjeje të qëndrueshme

Burimet bregdetare dhe detare janë pasuri e vyer ekonomike për Shqipërinë. Koncepti i ekonomisë blu është duke u përhapur nga Shqipëria si një

dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj, vlerësoi se përfitimet nga ekonomia blu janë të shumta, përfshirë peshkimin, turizmin bregdetar, transportin

zv. ministrin Roland Kristo, Prefektin e Qarkut Vlorë, Flamur Mamaj, zhvilluan një takim në zonën e Radhimës, Vlorë, me aktorët e sektorit të akuakulturës, ku diskutuan mbi problematikat dhe zhvillimin e këtyre resurseve në këtë zonë, në dobi të ekonomisë dhe mjedisit.

"Akuakultura ofron mundësi për rritje ekonomike, krijim të vendeve të punës, dhe kontribut në ekonominë e kësaj zone", tha Denaj.

Ministrja informoj përfaqësuesit e sektorit mbi përfitimet që gjenerohen nga zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Akuakulturës 2021-2030.

"Po përmirësojmë sektorin me financime në aspektet e prodhimit, krijimit të vendeve të punës, tregjeve, sigurisë së ushqimit, dhe eksportit të produkteve të detit", theksoj Denaj.



rrugë për parandalimin e degradimit të mjedisit dhe zhbalancimeve ekologjike.

detar, energjinë e erës detare, dhe zhvillimin e infrastrukturës së portit.

Ministrja e Bujqësisë Ministrja Denaj bashkë me

Dimërimi i bletëve - Bletërritësit duhet të kenë kujdes për mbrojtjen nga lagështia

Ata i kanë mbyllur ato në koshere ndërsa një kujdes i veçantë është treguar për trajtimin e sëmundjeve përpara këtij procesi, në mënyrë që kur të dalin nga dimërimi të jenë të pastra dhe të mos kenë humbje në mizë bën me dije, Kledian Kosturi, kryetar i Shoqatës së Bletërritësve në Korçë.

Kosturi thotë se prodhimi i këtij viti ishte i mbarë.



hen 52 mijë familje blete ndërsa është Bashkia e Korçës dhe e

Maliqit që ka numrin më të lartë të bletërritësve.

"Farat Autoktone", mbledh të korrat e para të prodhimeve vendase

Aktorë të linjës festuan të korrat e para të prodhimeve vendase fale zbatimit të projektit "Farat Autoktone".

Eventi "Të Korrat Fest" solli "një pjatë" plot me eksperiencë kulinare, muzikë dhe diskutime në lidhje me farat dhe prodhimet autoktone, duke përfshirë edhe nënshkrimin e një Memorandumi Mirëkuptimi ndërmjet

Bankës Gjenetike Shqiptare dhe Shoqatës Shqiptare të Agroturizmit, për të siguruar qëndrueshmërinë e projektit.

GIZ është krenar të mbështesë një iniciativë të tillë frymëzuese dhe do të vazhdojë të punojë së bashku me aktorët e përfshirë për të zgjeruar këtë projekt dhe për të kontribuar në vendosjen e va-

rieteteve autoktone në qendër të vëmëndjes. Ky event mbledhi bashkë përfaqësues të agroturizmit, shefa të kuzhinës, ekspertë të bujqësisë dhe turizmit dhe donatorë të tjerë, për të festuar të korrat e para të këtij projekti që u zhvillua tek Fustanella Farm, një nga agroturizmet e para që ka përfshirë këtë nismë.

Mbarështimi i të imtave - Blegtori që mori tokë me qira për rritjen e deleve

55-vjeçari, Nardi Murataj është prej të paktëve blegtorë në zonën e Myzeqesë, që po mbarështon tufë të madhe me bagëti të imta.

Është nga Vlora, por duke parë perspektivën e blegtorisë në vitin 2004 u vendos në Levan të Fierit. Qysh atëherë, e gjithë familja merret me mbarështimin e të imtave. Shitjen e qumështit e ka të garantuar në fabrikat e përpunimit në zonë.

Për sigurimin e bazës ushqimore për bagëtitë ka marrë me qira rreth 30 ha tokë. Kostoja



për të, thotë se është e lartë.

Ne zonën e Levanit dikur ka patur rreth 30 tufa me bagëti

tregon blegtori, ndërsa sot numërohen 4 - 5 tufa.

Prodhimi i qepës, shitet 80% e prodhimit në Maliq, pjesa tjetër e magazinuar

Prodhimi i qepës për këtë vit në Maliq ka qenë i mbarë ndërsa pozitivisht ka ecur dhe shitja e prodhimit. Fermerët kanë magazinuar vetëm 20% të prodhimit ndërsa pjesa tjetër është shitur fill pas vjeljes.

Vitin e kaluar çmimi i tregtimit të qepës u rrit ndjeshëm çka solli fitime të kënaqshme për fermerët ndaj dhe këtë vit, një pjesë e tyre po e ruajnë prodhimin për ta shitur më vonë.

"Prodhimi ka qenë i cilë-

sisë së mirë dhe si rendiment gjithashtu ka qenë i kënaqshëm nuk ka pasur probleme me sëmundje të ndryshme sepse fermerët që merren me kultivimin e kësaj kulture kanë fituar eksperiencë dhe herë pas here e kanë mbajtur nën kontroll këtë kulturë. Nga viti në vit mundohen të shtojnë sipërfaqet, tregu ka shkuar mirë dhe me çmim të kënaqshëm", thotë drejtori i bujqësisë dhe mbrojtjes se

konsumatorit në bashkinë Maliq, Arben Dulellari.

Në fushën e Maliqit fermerët këtë vit kanë mbjellë një sipërfaqe prej rreth 750HA me qepë. Zonat më potenciale për prodhimin e saj janë fshatrat e Njësisë Pojan dhe Pirg.

Kultura e qepës këtë vit pati prodhim cilësor në Maliq dhe 80% e prodhimit tashmë është shitur. Aktualisht çmimi i tregtimit të saj varion me 50-60 lekë kg

Sektorioza prek grurin specialisti Ilir Mehmeti: Të nisin trajtimet për mbrojtjen e të mbjellave

Sektorioza ose siç njihet ndryshe zverdhja e grurit ka prekur këtë kulturë në fushën e Maliqit.

Për të këshilluar fermerët mbi trajtimet që duhet të kryejnë për mbrojtjen e të mbjellave në këtë situatë është zhvilluar një takim me fermerë potencialë në fshatin Orman, ku i pranishëm ishte dhe specialisti i bujqësisë, profesor Ilir Mehmeti.

"Shkalla e infeksionit nuk është shumë e lartë dhe do të shohim për trajtime të mëvonshme në mars kur bima të jetë zhvilluar në dy nivele. Masat agroteknike janë kryesoret për kontrollin e kësaj sëmundjeje dhe u kemi rekomanduar varietetet që janë rezistente për këtë sëmundje, triorimin, dezinfektimin e farës dhe mbjelljen në afatet optimale," tha z. Mehmeti.

Gruri dhe misri janë 2 prej kulturave bujqësore që mbillen

më së shumti nga fermerët në fshatin Orman.

Gjatë vitit të kaluar, për

let sigurimi i tregut të shitjes.

Gjatë ditëve të fundit ka pasur reshje intensive shiu, çka



shkak të subvencionimit që fermerët përfituan nga skema mbështetëse e Qeverisë, pati një shtim të sipërfaqeve të mbjella me këtë kulturë me rreth 500 ha më tepër, por problem për ta nge-

ka sjellë prezencën e ujit në tokat e mbjella me grurë, ndaj këshillohen fermerët që të bëjnë kullimin e tyre në mënyrë që lagështia të mos sjellë shfaqjen e sëmundjeve në bimë.

GRATË NË SIPËRMARRJE

Si mund të arrihet fuqizimi ekonomik i grave?

Fuqizimi i grave në zonat rurale mbetet një sfidë e madhe për vendin. Në vitet e fundit, Shqipëria ka bërë përpjekje të rëndësishme për t'i trajtuar këto sfida përmes angazhimeve kombëtare për barazim gjinor. Kur gratë janë të fuqizuara nga ana sociale dhe ekonomike, ato shndërrohen në një forcë të madhe për ndryshim në komunitetin e tyre. Pabarazitë që ekzistojnë midis burrave dhe grave e bëjnë të vështirë që gratë të përdorin potencialin e tyre. Fuqizimi ekonomik i grave është një mjet i rëndësishëm për t'i mbështetur ato në luftën kundër abuzimit dhe diskriminimit brenda familjeve dhe komuniteteve ku ato jetojnë. Roli i grave në zinxhirët e vlerës në zonat rurale shkon përtej prodhimit. Ngritja e kapaciteteve të tyre për të marrë pjesë në të gjitha hapat, si përpunimi, paketimi, marketingu, etj., sjell përfitime afatgjate dhe të qëndrueshme për ekonominë rurale. Disa nga problemet kryesore në zonat rurale në Shqipëri janë niveli i ulët i teknologjisë bujqësore, copëtimi i tokës në biznese të vogla familjare me kapacitete të kufizuara kundrejt nismave bashkëpunuese në prodhim, përpunim dhe marketing.

Mbizotëron një mendësi individualiste që pengon prodhimin dhe konkurrueshmërinë. Këto probleme të zhvillimit rural kanë një ndikim të drejtpërdrejt në mungesën e përvojës së bizneseve të vogla dhe të mesme, në aksesin të financat dhe informacioni si dhe në mungesën e mbështetjes institucionale bazuar mbi stereotipe dhe perceptime. Fuqizimi rrit pavarësinë ekonomike të grave, fuqinë vendimmarrëse dhe liritë sociale duke sjellë një efekt pozitiv në marrëdhëniet gjinore në nivel familjar dhe komuniteti. Fuqizimi i grave përmes zhvillimit të klasterave ekonomikë përbën një mundësi të vërtetë për gratë, sipërmarrjet familjare dhe bizneset e vogla në Shqipëri. Anëtarët në një klaster operojnë në një mjedis biznesi që ofron 3 avantazhe kryesore për gratë. Së pari, sipërmarrëset gra do të operojnë në mënyrë më produktive duke qenë se mund të sigurojnë akses tek inputet kryesore, të tilla si furnitorët, informacionet, teknologjitë dhe institucionet e arsimit të lartë. Bizneset e vogla mund të sigurojnë akses në tregje dhe në informacione teknike. Anëtarët e klasterit përfitojnë edhe përmes përpjekjeve të përbashkëta në marketing, pjesëmarrje në panairë dhe mbrojtje të markave të

produkteve të tyre. Së dyti, anëtarët përfitojnë prej transferimit të njohurive, që krijojnë një burim novacioni. Së treti, klasterat inkurajojnë krijimin e biznesit të ri duke u bazuar te konsumatorët.

Është provuar se një grua e cila mund të marrë vendime mbi çfarë dhe sa të mbjellë apo përpunojë është më produktive në bujqësi si dhe krijon një parakusht për kujdes shëndetësor dhe ushqim më të mirë për fëmijët e saj. Zvogëlimi i hendekut gjinor në bujqësi përmes klasterave nuk ofron përfitime vetëm për anëtarët por dhe për sektorin në përgjithësi. Në këtë



mënyrë, rriten të ardhurat e familjeve të këtyre grave dhe përmirësohet oferta e produkteve si dhe kjo gjë ndikon në uljen e çmimeve dhe në pjesëmarrjen e lartë në tregun e punës. Grupimi i grave krijon mundësi për bashkimin e fuqive si dhe shumëfishimin e efekteve pozitive për shkak të së drejtës së përdorimit të të ardhurave të krijuara. Analizimi i efekteve të grupimit të grave në bujqësi kryesisht në vendet në zhvillim ka evidentuar se është arritur të rritet mundësia për financa dhe hyrje në tregje.

Në një përpjekje për të siguruar mbështetje për fuqizimin e grave përmes zhvillimit të klasterit ekonomik, KASH, në bashkëpunim me donator dhe institucionet te linjes po mbështet fuqizimin e Grave për përfitim ekonomik përmes angazhimit në bujqësi.

Në Dibër, kjo nismë synon të nxisë fuqizimin ekonomik dhe mundësitë e punësimit për gratë si dhe të zhvillojë, diversifikojë dhe promovojë klasterat ekonomikë dhe bizneset e vogla dhe të mesme në zonat rurale dhe periferike në Shqipëri.

Rezultatet e pritshme janë:

1. Hartimi i udhëzimeve për ngritjen dhe funksionimin e klasterave ekonomikë në fushën e agro-turizmit

2. Ngritja e një klasteri ekonomik pilot që synon fuqizimin e grave

3. Zgjerimi i aktivitetit

ekonomik dhe krijimi i vlerës së shtuar ekonomike

4. Forcimi i njohurive dhe kapaciteteve të aktorëve të përfshirë

5. Publikimi i arritjeve kryesore dhe promovimi i klasterit në nivel kombëtar. Profili i grupit të grave në Staravec. Prej vitesh tashmë, zhvillojnë aktivitetin e tyre një grupim prej 20 grash, të cilat me punën e tyre në bujqësi sigurojnë të ardhurat kryesore ose të vetme për familjen. Gratë janë angazhuar në disa drejtime, si prodhimi i jufkave, kultivimi dhe mbledhja e frutave, përpunimi i reçelit dhe kom-

postove, mbledhja e bimëve aromatike-mjekësore, shitja e nënprodukteve blegtorale, etj. Të gjitha punojnë në mënyrë të pavarur dhe secila ka një tipologji të fragmentuar të aktivitetit bujqësor. Ata bashkohen kryesisht në kuadër të pjesëmarrjes në aktivitete si panairët ku dhe janë promovuar. Ky grup është ndihmuar nga disa projekte dhe organizata, që ka ofruar asistencë të vazhdueshme për ta në drejtim të ngritjes së kapaciteteve në fusha si marketingu dhe aksesin në treg apo dhe bashkëpunimi me aktorët/strukturat e tjera me aktivitet në Dibër. Gjatë kësaj kohe, këtyre grave iu është krijuar mundësia jo vetëm të evidentojnë dhe zhvillojnë produktet e tyre, por edhe të marrin pjesë në veprimtari promovuese në nivel vendor dhe kombëtar. Ky grupim është aktualisht i regjistruar si shoqatë grash fermere në Dibër me qëllim përdorimin së bashku të mjeteve përpunuese të produkteve bujqësore, kryesisht të frutave të pyllit, njohjen dhe përvetësimin e teknikave të përpunimit bashkëkohor të produkteve bujqësore, ofrimin e ndihmës së ndërsjellë mes anëtarëve të grupit për përvetësimin e teknikave bashkëkohore të përpunimit të frutave, etj. Pavarësisht ndihmës së ofruar, grupi vazhdon të përballet me sfidat e grumbullimit të prodhimit dhe aksesit në treg.

Misioni vazhdon...

Arsimi profesional, Gega për ATSH-në: Rreth 60 % e nxënësve punësohen që në vitin e dytë, pagat në turizëm e IT mbi 1000 euro

Arsimi dhe formimi profesional prodhon forcën punëtore të së nesërme dhe, për rrjedhojë, luan një rol kyç në rritjen ekonomike, në gjenerimin e punësimit dhe në stabilitetin social.

Promovimi i arsimit dhe formimit profesional, si zgjedhja më e mirë për të rinjtë dhe si rruga më e sigurt dhe e shpejtë e integritetit të tyre në tregun e

madh”, shprehet ai.

Gega thekson se Strategjia do të zbatohet në dy faza. Faza e parë është ajo e kalimit të nxënësve të gjimnazëve në arsimin profesional. Po punohet mes drejtorive të ZAZ dhe shkollave të arsimit profesional, me prindërit dhe nxënësit për kalimin e nxënësve në arsimin profesional.



punës, vijon të mbetet një nga prioritetet e qeverisë, i konkretizuar me përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve në shkollat profesionale të vendit.

Drejtori i Politikave të Punësimit dhe Aftësisimit Profesional, Albin Gega në një intervistë për ATSH-në, bëri të ditur se strategjia për promovimin e arsimit profesional synon furnizimin e tregut të punës me nxënës të dalë nga shkollat profesionale që janë të kualifikuar në shkolla përkatëse.

“Detyra imediate që na del sot është rritja e nxënësve në arsimin profesional. Rritja e numrave në arsimin profesional do të thotë rritje e numrit në tregun e punës që efektivisht shkon në rritjen e ekonomisë, sepse ka një korrelacion të drejtpërdrejt midis kërkesave të tregut të punës dhe rritjes së këtyre ndërmarrjeve që operojnë. Do të thotë që në momentin që ti gjen krah punë dhe të kualifikuar padyshim, biznesi rritet, të ardhurat rriten, është një zinxhir që lidh këtë mekanizëm kaq të

Në fazën e dytë fokus do të jetë promovimi i arsimit profesional në panairë rajonale dhe kombëtare. Tashmë, informon ai, Ministria e Arsimit dhe Sportit ka nisur fushatën “Zgjidh zanafillën” që synon njohjen me arsimin profesional të nxënësve që në 9-vjeçare, në rang kombëtar.

“U shpjegohet vlera e arsimit profesional. Arsimi profesional mbase ka mbetur si koncept të nxënësit e prindërit si zgjedhje detyësore, por duhet parë si zgjedhje parësore, pasi sot nevojat e ekonomisë janë shumë të mëdha. Bizneset po kërkojnë forcë të shtuar pune”, shprehet Gega.

Sipas tij, sot në arsimin profesional, rreth 60 % e nxënësve punësohen që në vitin e dytë apo të tretë të shkollës. Dy sektorë, turizmi dhe TIK kanë kërkesa urgjente për punë të kualifikuar.

“Këta nxënës marrin paga shumë të denja. Rekorde mban Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK). Në bazë të gjurmueshmërisë që kemi bërë ne si ministri, kemi

informacione se niveli i punësimit shkon deri 70 % për degë të caktuara si turizmi dhe IT. Pagat në këtë sektor kalojnë edhe pagën mesatare që është 900 euro. Sektorë të tillë kanë shumë “uri” për profesionistë dhe për nxënës të formuar profesionalisht”, vuri në dukje Gega për ATSH.

Një prej sfidave kryesore është bërja e sistemit shqiptar të AFP-së më shumë tërheqës, pasi tradicionalisht sistemi i AFP-së është konsideruar si një rrugë dytësore drejt arsimit të lartë për ata me rezultate të ulëta që vijnë nga arsimi bazë.

Gega e konsideron detyrë kombëtare, drejtimin e fëmijëve drejt arsimit profesional.

“Një nxënës që nuk ka prirje shkencore, jo vetëm për të ndjekur universitetin por për të qenë i mirë do të jetë kategori e papunësueshme. Çdo njeri e ka një dhunti dhe duke qenë në arsimin profesional, ai mund të shndërrohet në një profesionist shumë të mirë. Nesë ai mund të ketë edhe biznesin e vet. Modellet e vendeve të zhvilluara të botës na kanë treguar se shkollat e arsimit profesional prodhojnë jo vetëm profesionist, por edhe biznesmenë të së ardhmes. Për vet këtë arsye arsimi profesional merr përparësi ndaj gjimnazit. Ndaj detyra imediate mbetet rritja e numrave. Ne jemi besimplotë që duhet ta bëjmë këtë gjë, duhet ta bëjmë me çdo kosto sepse është detyrë kombëtare”, shprehet ai.

Sistemi shqiptar i AFP-së përbëhet nga dy shtylla të rëndësishme: AFP fillestare dhe formimi profesional / AFP e vazhduar.

Programet e AFP-së fillestare në shkollat publike të AFP-së kanë një kohëzgjatje prej katër vitesh.

Shumica e programeve të formimit ndjekin strukturën 2+1+1 e cila konsiston në një formim profesional bazë dyvjeçar, një vit specializim dhe një vit fazë konsolidimi.

Denaj: Agroturizëm “Fustanella”, shije e traditës me produktet bio të zonës së Petrelës

Johana, është një sipërmarrëse e suksesshme në një zonë shumë afër Tiranës, ku shtëpinë e të parëve të saj e ktheu në një “boutique” të vërtetë agrikulture duke i dhënë edhe më shumë vlerë diplomës së Universitetit Bujqësor, e duke u kthyer në frymëzim për studentët e shume gra në biznes.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj, përcolli sot në rrjetet sociale shembullin e Johanës dhe restorantit të saj “Fustanella”, si modelin e agroturizmit ku ofrohet një kulinar e kombinuar shijesh dhe traditës me produktet bio të zonës së Petrelës.

Denaj e cilësoi këtë sipërmarrje një oaz pranë kryeqytetit, ku kupton sa bujare është toka e

sa shumë mundet të prodhojë nëse i jep dashuri, përkushtim e shumë punë.



AGROTURIZËM

Kumbaro: Nis puna për strategjinë e Turizmit 2024 - 2030

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Mirela Kumbaro bëri të ditur se ka filluar puna mbi strategjinë e Turizmit 2024 - 2030, përmes një metodologjie të mirëstudiuar dhe me ekspertizën e GIZ.

Në një postim në rrjetet sociale Kumbaro tha se “duam të hartojmë një strategji që të jetë realiste, e zbatueshme dhe të drejtojë politikën e sektorit të turizmit deri në vitin 2030, me dinamikën e tij që shpesh herë edhe i tejkalon parashikimet”.

“Të gjithë janë të ftuar në tryezat e konsultimeve, që në përfundim të kemi produktin i cili do t’u shërbejë subjekteve publike, atyre private, bizneseve të hoteleri turizmit, të udhëtimit, organizatave, shoqatave dhe gjithë grupeve të interesit për të krijuar vizionin e tyre drejt produkteve turistike të qëndrueshme me ambicien se në mbarim të afatit të kësaj strategjie do ta kemi kthyer Shqipërinë në kampion të turizmit në Ballkan”, tha Kumbaro.

Shqipëria gjatë këtij viti ka

shënuar një numër rekord turistësh. Përveç shifrave të larta, Shqipëria ka përjetuar edhe një ‘bum’ të promovimit mediatic



botëror të potencialeve të saj turistike, deri tani shumë pak të zbuluara për botën.

Përveç vizitorëve nga Kosova, që mbajnë vendin e parë në të njëjtat shifra si vitin e kaluar, gjatë këtyre muajve tregje interesante paraqiten Spanja, Italia, Turqia, Mali i Zi, Franca, etj.

Vendi ynë ka kushte për turizëm gjithëvjetor, për shkak të relievit, që ofron mundësi për turizëm nga jugu, në veri.

Fshatrat turistike të veriut të vendit njohin së fundmi numër të lartë turistësh, ndërsa po zhvillohet edhe infrastruktura për turizmin e aventurës.

Shqipëria po ashtu ka lumenj të shumtë, laguna dhe parqe kombëtare, të cilat thithin turistë nga e gjithë bota.

Destinacion turistik, shtegu që lidh malet mes Shqipërisë, Kosovës e Maqedonisë

Shtegu ndërkombëtar i turizmit malor në rajonin ndërkombëtar dhe ekspertë të turizmit, shënoi përfundimin e

operatorë dhe ekspertë të turizmit, shënoi përfundimin e

përmes Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut, ku përveç panoramës fantastike, e tillë është edhe mikpritja e banorëve vendas për miqtë dhe këdo që përshkon këtë shteg.

Eksploratorët e High Scardus Trail, prezantohen me turizmin e natyrës dhe aventurës duke i promovuar në botë, bukuritë e kësaj zone të Ballkanit në mënyrën më të mirë të mundshme për të ndarë mikpritjen, bujarinë dhe panoramën plot ngjyra.

Ka mbetur ende shumë punë përpara, grupi që po punon për më shumë promovim të këtij shtegu, shprehet se është në një pjesë të mirë të këtij rrugëtimi, për të nxitur të apasionuarit të fillojnë të planifikojnë aventurën tuaj të ngjites malore për vitin 2024, ku i pret një përvojë e re.



fitar midis Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës është kthyer tashmë në një destinacion të turizmit rajonal dhe më gjërë.

Eventi final i High Scardus Trail me partnerë lokalë,

punës zhvillimore të produktit, si edhe përmbylljen me sukses të sezonit të parë të shtegut.

Ky shteg përbëhet nga 6 parqe kombëtare dhe një total prej 495 km shtigjesh.

High Scardus Trail shtrihet

Turizmi në Shkodër, 4 ide zhvillimi i shtohen platformës TIP

Platforma Inovative e Turizmit (TIP) ka mirëpritur gjatë këtyre javëve profesionistë të turizmit, guida dhe operatorë turistikë, strukturat e mikpritjes, për të krijuar modele alternative të turizmit, produkte turistike që ruajnë dhe promovojnë trashëgiminë kulturore, janë miqësore me mjedisin dhe kanë potencialin për të sjellë në vëmendje një destinacion turistik.

Rrugëtimi i identifikimit të TIP-ave të turizmit u mbyll të mërkurën me shumë emocione në Shkodër.

9 ide të reja për aventurën, liqenin, traditën, zakonet, kulturën dhe natyrën u prezantuan me shumë entuziazëm nga profesionistët e turizmit lokal.

Platforma Inovative e Turizmit (TIP) i shtohen edhe 4 ide shkodrane që do të mbështeten për zhvillim në produkte turistike të reja: 1. Shtegtim të rrëzave; 2. Amëza e Dheut; 3. Shtegu i Bleve; 4. Rreth liqenit me biçikletë.

Organizatorët e TIP falenderuan të gjithë aktorët që kontribuan me ide, kohë dhe dedikim për ta bërë TIP një

rrugëtim të bukur.

TIP bën të ditur se, do të nisë punën vitin që vjen, në 2024, duke implemtuar 21 eksperiencën të reja që vijnë direkt nga sektori turistik, anëmbanë Shqipërisë.

Ndërsa Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, bën të ditur se, “nëpërmjet TIP synohet të aktivizohen veçanërisht aktorët lokalë të turizmit dhe ata të rinj të cilët kanë dëshirë ta kthejnë turizmin në profesionin e tyre, duke i ftuar të japin ide për zhvillimin turistik të territorit të tyre”.

Akademia e Shkencave forum mbi sfidat e turizmit për një edukim cilësor dhe digjitalizim

“Turizmi 2030: Sfida për një edukim cilësor dhe digjitalizim”, titullohet forumi i organizuar nga Komisioni i Shkencave Ekonomike, Çështjeve Sociale dhe Juridike i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Në forum morrën pjesë, studiues, anëtarë të komisionit, pedagogë universiteti.

Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të politikave ndërkombëtare dhe zhvillimeve të industrisë së turizmit në vendin tonë, veçanërisht në vitet e fundit, por dhe në këndvështrimin e zhvillimit në perspektivë të këtij sektori.

Forumit e çeli Anastas Angjeli, i cili foli rreth reformës së suksesshme që ka zbatuar Akademia e Shkencave të Shqipërisë në zbatimin e shkencave bazike në ato aplikative.

Në këtë rast Komisioni i Shkencave Ekonomike, Çështjeve Sociale dhe Juridike i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë ofron ekspertizën e duhur për një nga sektorët më jetik të ekonomisë së vendit.

Forumit e përshëndeti edhe Zv/ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Vilma Bello, e cila mbajti temën “Si do të merketohet Shqipëria në 2030: nevojat për edukim”.

Zv/ministria Bello theksoi mobilizimin e komunitetit akademik/shkencor për hulumtim të çështjeve të turizmit.

“Kjo ka një rëndësi thelbësore në zhvillimin e turizmit si sektor dhe në pasurimin përm-

bajtësor të analizave dhe diskutimeve që ka zgjuar ky sektor. Disa ditë më parë shënuam 9 milionë turistë për këtë vit në



Shqipëri, një arritje e jashtëzakonshme për të gjithë sektorët kontribues në turizëm”, nënvizoi Bello.

Kjo, vijoi Bello, vjen pas publikimit të fundit të Organizatës Botërore të Turizmit (UNWTO) të barometrit të turizmit botëror, ku Shqipëria renditet në vendin e tretë në botë dhe të parin në Evropë për rritjen e flukseve të vizitorëve të huaj (+56%) për muajt janar-korrik 2023.

Në takim referuan dhe diskutuan Prof.dr. Klodiana Gorica me temën “Sfidat e turizmit shqiptar në kontekstin Rajonal: Edukimi, kërkimi shkencor dhe modelet e zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm”, akademike e asociuar, Kozeta Sevrani me temën “Zhvillimet e teknologjisë digjitale në turizëm”, Elona Shehu, dhe Eni Nasi me temën, “Pozi-

cioni i turizmit në ekonominë e Shqipërisë nëpërmjet modelit Input-Output”.

Një nga risitë e forumit është

lidhja e ngushtë e dijeve bazike me ato të aplikuar.

Në këtë kontekst në forum referuan Enver Mehmeti nga kompania turistike VAS TOUR me temën “Turizmi i qëndrueshëm dhe sezonaliteti”, përfaqësues nga Elite Travel Group me temën “Digjitalizimi në mikpritje dhe turizëm” dhe Menaxheri i Përgjithshëm Mr. Selcuk Kazan nga Hilton Garden Inn me temën “Roli i biznesit në krijimin e mundësive për forcën e punës në Shqipëri për t’u aftësuar për të punuar në industrinë e hoteleri-turizmit”.

Në fund të forumit pati shkëmbime mendimesh, pyetje dhe përfundime që referuan gjendjen e turizmit në Shqipëri dhe sfidat për të arritur standardet moderne në këtë sektor jetik për ekonominë e vendit.

Konkursi ndërkombëtar për parkun e Vjosës, MTM: Më 6 dhjetor shpallet studioja arkitekturore fituese

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit informoi se më 6 dhjetor do të shpallet studioja arkitekturore fituese për Konkursin Ndërkombëtar të Dizajnit për Qendrën Multifunkcionale të Vjosës.

shpalljes së këtij rajoni si një Park Kombëtar.

Qendra Multifunkcionale do të shërbejë si një portë e Parkut Kombëtar të Lumit Vjosa, ku vizitorët do të nisin udhëtimin

ndërkombëtare dhe për t’u lidhur me liderët e industrisë.

“Ne jemi në kërkim të zgjidhjeve arkitekturore në harmoni të plotë me natyrën dhe peizazhin, propozime që do të shërbejnë si katalizatorë për rëndësinë kombëtare të kësaj zone. Konceptet duhet të bazohen në parimet e krijuara duke identifikuar karakteristikat natyrore, trashëgiminë, vlerat kulturore, historike dhe arkeologjike të zonës, si dhe në përvojat më të mira ndërkombëtare”, thuhet në mesazhin që shoqëroi shpalljen e këtij konkursi.

Në 13 qershor 2022 u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe organizatës amerikane “Patagonia” për nisjen e punës së përbashkët për ta shpallur Vjosën “Park Kombëtar”.

Më 13 mars të këtij viti, lumi i Vjosës, i fundit i egër në Evropë, u shpall nga qeveria shqiptare “Park Kombëtar”, kategoria e dytë e mbrojtjes, që është shumë më e lartë nga ajo që kishte deri një vit më parë, thjesht “park natyror”.



Ky konkurs është iniciuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, dedikuar krijimit të një “Qendre Multifunkcionale dhe Stacioneve të Informacionit” për Parkun Kombëtar të Lumit të Egër Vjosa.

Projekti për Qendrën Multifunkcionale në Vjosë cilësohet i një rëndësie të veçantë pas

dhe marrin informacione për vlerat natyrore dhe kulturore të parkut, në zemër të ekosistemeve natyrore, por edhe të habitatit njerëzor.

Konkursi Ndërkombëtar i Dizajnit synon të bashkojë studiues inovative dhe kreative të dizajnit nga të gjitha anët e globit. Ai ofron një platformë unike për studiues për të shfaqur talentin e tyre, për të ftuar njohje



SHOQATAT ANËTARE

AVALB FEDINVEST BKFSH EKR IBMA HABA AOA UPM LEAA ADAMA ABA SHGF ALBAFLOR

SHKPVF RKUK SVP MSHKM BIOADRIA PPAM SHT UOTSH KEA BIOPANT ADAD PSN

KËSHILLAT RAJONALE

TIRANA DURRESI FIERI ELBASANI SHKODRA DIBRA

LEZHA GJIROKASTRA KORÇA BERATI VLORA KUKESI



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



KREDI E SHPEJTË MIKRO PËR ÇDO QËLLIM BIZNES APO INDIVID

KREDI MIKRO

deri në **2,500,000** LEKË



FAO, mbështetje për vlerësimin e dëmeve nga ndryshimet klimatike në sektorët agrourbues

FAO është e angazhuar të mbështesë vendet për të vlerësuar shkallën dhe përmasat e humbjeve dhe dëmeve të shkaktuara nga ndikimet e krizës klimatike në sektorët agrourbues; mobilizimin e burimeve financiare të përshtatshme dhe të parashikueshme për të mbështetur zbatimin e veprimeve të humbjeve dhe dëmeve në sektor; vlerësimin e rreziqeve klimatike; zvogëlimin e humbjeve dhe dëmeve në bujqësi; dhe zhvillimin e teknologjive dhe praktikave të reja që mund të zvogëlojnë ekspozimin dhe cenueshmërinë e prodhuesve dhe konsumatorëve të ushqimit ndaj rreziqeve klimatike, të tilla si kulturat tolerante ndaj thatësirës, sistemet e ujitjes efikase ndaj ujit, sistemet e paralajmërimit të hershëm, sigurimi i të korrave dhe skemat e mbrojtjes sociale.

Kështu u shpreh Qu Dongyu, drejtor i përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë (FAO) në takim që po mbahet në Dubai, për klimën, ku u vu theksi në faktin se ndikimet e krizës klimatike vazhdojnë të tejkalojnë kufijtë e përshtatjes dhe vendet po kërkojnë urgjentisht mënyra për të kompensuar humbjet dhe dëmet në bujqësi.

Ai tha se, klima në ndryshim është kthyer në një krizë ushqimore dhe bujqësore. Fermerët e vegjël janë gjithnjë e më shumë në mëshirën e fatkeqësive të shkaktuara nga ndryshimet klimatike dhe ngjarjeve ekstreme. Duke pasur parasysh varësinë e plotë që ata kanë nga kushtet e motit dhe burimet natyrore për rendimente dhe prodhime të shëndetshme, sektori agrourbues është në vijën e parë të krizës klimatike.

“Ndryshimet klimatike po ndikojnë në kapacitetin tonë për të prodhuar ushqim, duke ndryshuar disponueshmërinë, aksesin dhe përbalueshmërinë e ushqimit, si dhe cilësinë e ujit, tokës dhe biodiversitetit, duke rritur shpeshtësinë dhe intensitetin e ngjarjeve ekstreme të motit dhe duke ndryshuar modelet e dëmtuesve, dhe sëmundjeve. Këto ndikime rrisin pasigurinë ushqimore, duke reduktuar rendimentin e të korrave, produktivitetin e blegtorisë dhe potencialin e peshkimit dhe akuakulturës si prodhues të ushqimit”, theksoi Dongyu.

Sipas tij, gjatë 30 viteve të fundit, rreth 3.8 trilionë dollarë prodhime bujqësore dhe blegtorale janë humbur për shkak të ngjarjeve klimatike dhe fatkeqësive të tjera, që korrespondon me një humbje mesatare prej 123 miliardë dollarë në vit, ose 5 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto vjetore bujqësore globale. Këto ngjarje fatkeqësive janë rritur gjithashtu, nga rreth njëqind në vit në vitet 1970 në një mesatare aktuale prej katërqind në vit. Duke qenë se bujqësia, përfshirë prodhimet bujqësore dhe blegtorale, pylltarinë, peshkimin dhe akuakulturën, është një nga aktivitetet kryesore ekonomike në vendet në zhvillim, implikimet janë të thella.

Dongyu, u shpreh se, fermerët janë përshtatur me shekuj me ndryshimet në mjedisin e tyre. Ato janë investimi më i mirë në ndërtimin e elasticitetit dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Por ajo që ata po përjetojnë sot shkon përtej aftësisë së tyre për t'u përshtatur. Mbështetja në trajtimin e humbjeve dhe dëmeve ekonomike dhe joekonomike të shkaktuara nga ngjarjet ekstreme dhe të ngadalta, po bëhet një mjet

shpëtimi për komunitetet dhe vendet bujqësore.

Sipas tij, ngritja dhe funksionimi i financimit të humbjeve dhe dëmeve dhe, më e



rëndësishmja nga të gjitha, shpërndarja e financave për humbjet dhe dëmet do të jetë një provë për sukses në Samitin e Klimës COP28 të Kombeve të Bashkuara. Raporti ynë i fundit mbi Humbjet dhe Dëmtimet në Sistemet Agrourbues, i cili do të prezantohet në COP28, zbulon se mbi një e treta e angazhimeve të vendeve për klimën ose Kontributet e Përcaktuara Kombëtare (NDC) i referohen në mënyrë eksplicite humbjeve dhe dëmeve. Për ato vende që i referohen humbjeve dhe dëmeve, bujqësia në përgjithësi rezultojnë të jetë sektori i vetëm më i ndikuar.

“Krizat klimatike dhe ushqimore janë të pandashme. Investimi në zgjidhjet e sistemeve agrourbues për ndryshimet klimatike do të sjellë shpërblime të mëdha për njerëzit dhe planetin. Por as fermerët më të qëndrueshëm nuk mund të përshtaten me të gjitha efektet e krizës klimatike. Fermerët e vegjël dhe vendet në zhvillim të varura nga bujqësia duhet të jenë në krye të përpjekjeve tona kolektive për të trajtuar humbjet dhe dëmet pasuese”, deklaroi ai.

Opinion: Lessening the blow of climate-related loss and damage

As the impacts of the climate crisis continue to surpass the limits of adaptation, countries are urgently searching for ways to redress the losses and damages to agriculture. This op-ed discusses ways to limit loss and damage through various means, including increased climate finance and Anticipatory Action

By Qu Dongyu / 20 November 2023

intensity of extreme weather events, and shifting the patterns of pests and diseases. These impacts increase food insecurity, reducing crop yields, livestock productivity, and the potential of fisheries and aquaculture as food producers.

Over the last 30 years an estimated USD 3.8 trillion worth of crops and livestock production has been lost due to climate and other disaster events, corresponding to an average loss of USD 123 billion per year, or 5 percent of annual global agricultural GDP. These disaster events have also been increasing, from around one hundred per year in the 1970's to a current average of four hundred per year. As agriculture, including crops and livestock production, forestry, fisheries, and aquaculture, is one of the main economic activities in developing countries, the implications are profound.

Farmers are resilient and have for centuries adapted to changes in their environments. They are the best investment in building resilience and adapting to climate change. But what they are experiencing today goes beyond their ability to adapt. Support in dealing with both the economic and non-economic losses and damage caused by extreme and slow onset events is becoming a lifeline for farming communities and countries.

Getting the loss and damage funding up and running and, most important of all, distributing finance for loss and damage will be a litmus test for success at the United Nations COP28

climate summit. Our latest report on Loss and Damage in Agrifood Systems, which will be launched at COP28, reveals that, over a third of countries' climate commitments or Nationally Determined Contributions (NDCs) explicitly refer to loss and damage. For those countries referring to loss and damage, agriculture is overall found to be the single most impacted sector.

FAO is committed to supporting countries to assess the extent and magnitude of loss and damage caused by the impacts of the climate crisis on the agrifood sectors; mobilizing adequate and predictable financial resources to support the implementation of loss and damage actions in the sector; assessing climate risks; reducing loss and damage in agriculture; and developing new technologies and practices that can reduce the exposure and vulnerability of food producers and consumers to climate risks, such as drought-tolerant crops, water-efficient irrigation systems, early warning systems, crop insurance and social protection schemes.

The climate and food crises are inseparable. Investing in agrifood systems solutions to climate change will bring big rewards for people and for the planet. But not even the most resilient farmers can adapt to all the effects of the climate crisis. Small-scale farmers and agriculture-dependent developing countries must be at the forefront of our collective efforts to address the consequent loss and damage.

Banka Botërore: Katër sfidat më të mëdha për bujqësinë e qëndrueshme në Ballkanin Perëndimor

Gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor – Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia – i kanë zgjeruar ekonomitë e tyre që nga fillimi i viteve 1990, duke iu bashkuar grupit të vendeve me të ardhura të mesme të larta. Megjithatë ekonomitë e tyre janë më të diversifikuara sot, bujqësia ende punëtorë një të tretën e fuqisë punëtore dhe është një burim i rëndësishëm mirëqenieje në disa vende si Shqipëria. Investimi në bujqësi për rritjen e produktivitetit, konkurrencës dhe elasticitetit mes kushteve më ekstreme të motit në Evropë për shkak të ndryshimeve klimatike, është si rrjedhim thelbësor për të ndihmuar rajonin të përfitojë nga mundësitë e reja që vijnë së bashku me procesin e vazhdueshëm të anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE). Kjo do të jetë e mundur vetëm kur t'i kushtohet më shumë vëmendje gjelbërimit të sektorit nëpërmjet përshtatjes dhe

zbutjes së klimës.

Sektori i bujqësisë në Ballkanin Perëndimor aktualisht ka një gjurmë relativisht të ulët të karbonit, por kjo është kryesisht për shkak të ruralitetit të lartë dhe intensitetit të ulët të bujqësisë sesa rezultat i zgjedhjeve strategjike të politikave. Për të adresuar ndikimet në rritje klimatike, Ballkani Perëndimor duhet të trajtojë katër sfidat kryesore që kanë vazhduar të prekin komunitetet e fermerëve - çështjet strukturore në sistemet bujqësore, mbështetjen e fermave të shoqëruara me prodhimin (d.m.th., subvencionet e lidhura me prodhimin e kulturave specifike dhe/ose produkteve blegtorale), procesi i ngadaltë i gjelbërimit dhe kapaciteti i dobët institucional.

Feramat e fragmentuara dhe

mbijetuese. Madhësia mesatare e fermave në Ballkanin Perëndimor varion nga një e treta (Serbi) në një të dhjetën (Shqipëri) e madhësisë së mesatare së BE-së prej 16 hektarësh. Feramat e mbijetesës gjenden ende në shumë vende. Ato karakterizohen nga sisteme prodhuese me intensitet të ulët, përdorimi i kufizuar i plehrave dhe kimikateve, prodhimi në rënie blegtorale dhe emetimet më të ulëta të gazeve serrë bujqësore. Madhësia e vogël e fermës dhe emigracioni masiv rural pengojnë investimet, duke e mbajtur sektorin më pak produktiv dhe konkurrues.

Shpenzimet publike jo-produktive. Pavarësisht një buxheti bujqësor të konsiderueshëm dhe në rritje si pjesë e PBB-së dhe rritjes së asistencës

së para-anëtarësimit (IPARD) dhe financimit të donatorëve, Ballkani Perëndimor përballet me një hendek të madh me BE-në në mbështetjen e bujqësisë së zgjuar për klimën. Për më tepër, shpenzimet publike aktuale u përqendruan në mbështetjen e rritjes së prodhimit përmes subvencioneve të shoqëruara, duke mos përputhur me Politikën e re të Përbashkët Bujqësore të BE-së (CAP). Formimi i kapitalit të fermave dhe investimet në Sistemin e Njohurive dhe Inovacionit Bujqësor (AKIS) janë dukshëm të shkurtra në krahasim me BE-në, duke i lënë feramat të nënkapitalizuara dhe më pak produktive.

Mungesa e dixhitalizimit për bujqësinë e zgjuar për klimën. Shumica e vendeve të Ballkanit Perëndimor u mungojnë siste-

meve dixhitale këshilluese për feramat për përhapjen e bujqësisë së zgjuar për klimën, e cila synon fitore të trefishta në produktivitet dhe të ardhura, elasticitet klimatik dhe reduktim të emetimeve. Një qasje e integruar mund të transformojë bujqësinë në Ballkanin Perëndimor.

Kapaciteti i kufizuar institucional. Për të përfutur nga reformat në bujqësi, rritja e investimeve është e nevojshme për të nxitur institucionet që ofrojnë shërbime publike thelbësore. Nevojiten fonde dhe vëmendje shtesë nga autoritetet për masat e laboratorit e sigurisë ushqimore, kërkimin, inovacionin dhe zgjerimin, marketingun dhe infrastrukturën logjistike.

Megjithatë gjurma aktuale e karbonit në sektorin e bujqësisë në Ballkanin Perëndimor është

më e vogël se mesatarja e BE-së, emetimet e bujqësisë pritet të rriten me konvergencën e vazhdueshme të rajonit me bllokun.

Fokusi i Bankës Botërore për Gjelbërimitin e Bujqësisë në Ballkanin Perëndimor ofron shpresë, në përputhje me Axhendën e Gjelbërimit për Ballkanin Perëndimor. Raporti propozon tetë rekomandime politikash, duke nxjerrë mësim nga tranzicioni i gjelbërimit të bujqësisë së BE-së dhe duke marrë parasysh zonat e ndryshme agro-ekologjike dhe peizazhet natyrore të rajonit. Së bashku me procesin e gjelbërimit, në qendër të vëmendjes theksohet rëndësia e politikave sociale që mbështesin diversifikimin në fermë dhe mundësitë alternative ekonomike për të siguruar një transformim të drejtë dhe rezistent ndaj klimës së ekonomisë bujqësore dhe rurale të rajonit, duke ndihmuar në ndërtimin e një të ardhmeje më elastike dhe të qëndrueshme.

TEKNOLOGJI

Si ta shohim Inteligjencën Artificiale?!

Shfaqja në ekranin e lajmeve të Euronews.al, e spikeres së prodhuar nga inteligjenca artificiale ngjalli diskutime, mbi të gjitha për rrezikun e vendeve të punës. Më tej, mungesa ose jo e emocioneve ishte një temë tjetër debati. Vendi ndodhet në kushtet kur shumë kompani kërkojnë punonjës, por nga ana tjetër, aftësia e sipërmarrjeve dhe institucioneve për të investuar në teknologji mbetet e ulët. A duhet të kemi frikë nga inteligjenca artificiale? A rrezikohen vendet tona të punës dhe siguria e informacionit? Për këtë kemi zhvilluar një intervistë me Hatixhe Bilibashi, themeluese e STEM Hub Albania dhe e Albanian ICT Academy.

Së fundi, një spikere AI ka prezantuar lajmet në Euronews.al. A mund të na thoni cilat janë kushtet tona për të investuar në projekte të tilla?

Shqipëria është ende shumë herët për t'i zëvendësuar profesionistët nga AI. Duhet shumë faktorë bashkë për të arritur në përdorimin masiv të Inteligjencës Artificiale. Duhet shumë investime, që nga krijimi dhe mirëmbajtja e software-ëve të tillë.

Në Shqipëri kemi dy realitete, në njërin anë tentativë për teknologji shumë të zhvilluara dhe në anën tjetër, një pjesë e mirë e kompanive përdorin teknologji shumë të vjetra, si hardware dhe software. Euronews.al duhet përgëzuar për këtë inovacion, që e bëri të prekshëm dhe për Shqipërinë. Uroj të kemi sa më shumë kompani që të sjellin teknologji në të tilla nivele, jo vetëm në media, por në çdo fushë; mjekësi, edukim, industri të ndryshme dhe pse nuk kemi shumë industri në vendin tonë. Inovacioni është një fushë që kërkon kulturën e duhur për t'u aplikuar dhe sjell zhvillimin e një vendi në shumë drejtime.

Nëse ia dalim të investojmë, a do të përbënte vërtetë rrezik për profesionistët?

Inteligjenca Artificiale nuk përbën aspak rrezik për profesionistët e vërtetë, por e bën punën më të lehtë dhe më komode. U jep mundësi të optimizojnë kohën për një punë më cilësore. Në vendet e zhvilluara, mjekët, nëpërmjet inteligjencës artificiale, kanë realizuar kirurgji shumë sensitive. Robotët shoqërojnë pacientët me aftësi të kufizuara për shërbime personale, ose përdorimi i inteligjencës artificiale në edukim, janë disa nga treguesit se sa zhvillim po sjell inteligjenca artificiale.

Profesionistët nuk rrezikohen në asnjë moment. Inteligjenca artificiale sot ndërton dhe programe e aplikacione të plota, por kjo nuk e rrezikon punën e një programuesi profesionist, ashtu si nuk rrezikohet profesioni i mjekut, gazetarisit apo mësuesit.

Le të shikojmë përfitimet e inteligjencës artificiale dhe të përshtatemi dhe aftësojmë të rinjtë për përdorimin e saj.

Rrezikun më të madh e sjellin njerëzit, në mënyrën se si do të përdorin inteligjencën artificiale. Paralelisht me çdo zhvillim, ka ecur e mira dhe e keqja. Shoqëria duhet të edukohet me përdorimin pozitiv të këtyre teknologjive, si gjithçka tjetër që na rrethon në realitetin tonë të përditshëm. Nuk duhet të fajësojmë inteligjencën artificiale për atë që mbart njerëzimi.

Kohët e fundit shumë kompani po vuajnë për punonjës. Nëse mund të na vlejë AI në këtë drejtim, nga duhet t'ia nisim?

Ka disa profesione sot që nuk arrijnë të mbulojnë me profesionistë në të gjithë botën. Kjo për disa arsye, siç është lëvizja e lirë dhe e drejta e secilit prej nesh të zgjedhë ku do të jetojë si dhe zgjedhja e profesioneve sa më komode. Brezat

e rinj kanë lindur në momentet kur teknologjia ka qenë shumë e zhvilluar.



Si treg i vogël dhe si vend i vogël, por me shumë resurse që Zoti na ka bekuar për t'i shfrytëzuar, ne duhet të punojmë shumë me të rinjtë në zhvillimin e karrierës. Orientimi dhe përgatitja e të rinjve për atë që tregu ka nevojë më shumë, do t'ju sjellë një punësim më të sigurt dhe të mirë-paguar. Aty ku nuk mundemi me profesionistë, patjetër inteligjenca artificiale është një opsion shumë i mirë për t'u përdorur.

Ku duhet të fokusohemi në punët që mund të sigurojnë vlerë të shtuar dhe të vlejshme për njerëzit?

Profesionet në fushën e teknologjisë: Inxhinierët Software, CyberSecurity, GameDevelopment, Inteligjenca Artificiale etj. Kemi dhe shumë fusha të tjera që nuk i zëvendëson asnjëherë inteligjenca artificiale apo teknologjia si mjekësia, arti, studimet shkencore, industrinë e ndryshme, energjia e rinovueshme dhe mjedisi, menaxher projektesh, menaxher shitjesh, gjithçka që lidhet me kreativitetin, etj.

Në krijimin e përmbajtjes online, ka një diskutim të madh. Disa media ndërkombëtare nuk i japin akses ChatGPT në infot e tyre. Çfarë komenti keni për këtë?

Ndoshta shumë shtete nuk janë gati akoma për monitorimin e ChatGPT, ashtu si dhe

Shqipëria. Për ruajtjen e pronësisë intelektuale duhen ngritur politikat e duhura të sigurisë dhe mbrojtjes së informacionit. Jetojmë në epokën digjitale dhe teknologjia po merr zhvillim me përmasa gjigande. Me të njëjtin hap duhet të zhvillohen dhe rregullatorët dhe politikat e duhura për mirëfunksionimin e inteligjencës artificiale.

Nisur nga fakti se qendra juaj është fokusuar në fushën e teknologjisë, çfarë mund të na thoni në drejtimin e edukimit IT tek të rinjtë? Si t'i orientojmë ato më mirë? Çfarë duhet të bëjnë shkollat publike?

Albanian ICT Academy është e fokusuar në edukimin e fëmijëve, të rinjve dhe profesionistëve në ICT. Është shumë e rëndësishme të kthehet vëmendja në edukimin cilësor dhe të studiohet nevoja që tregu ka. Nevojitet studim i tregut për mundësitë e punësimit, orientimi i të rinjve në profesionet më të kërkuara për tregun shqiptar dhe ndërkombëtar dhe përmirësimi i kurrikulave dhe metodologjive të mësimdhënies.

Me sistemin tonë arsimor duhet të profilizojmë të rinjtë sipas prirjeve që kanë në studimet e tyre. Kjo mund të fillojë të aplikohet që sistemin arsi-

mor 9-vjeçar, siç e kanë shumë vende të zhvilluara. Dikush që është talent në art nuk mund të zgjedhë programimin, thjesht sepse është më i paguar si profesion, sepse i heq mundësinë vetes për një sukses të sigurt në atë që ka talent dhe njëkohësisht nuk siguron sukses në fushën e programimit që zgjedh, sepse nuk është pikë e fortë për të. Të identifikojmë talentin e të rinjve dhe të investojmë në të, është suksesi më i madh i një sistemi arsimor për të ardhmen.

Le të flasim për AI, por ndërkohë shumë vende nuk kanë akses në internet? Cili do të ishte sygjërimi/kërkesa juaj për qeverinë?

Aktualisht qeveria e ka në fokus teknologjinë, duke mbështetur të rinjtë me bursa 50% ose 100% punëkërkuësit e papunë për kurset profesionale të programimit që ne ofrojmë. Gjithashtu, ka filluar kodimin në disa shkolla që në moshë të hershme.

Përtej këtyre dhe sa po bëhen për teknologjinë një kërkesë emergjente është infrastruktura e duhur në të gjitha shkollat dhe në zonat më të thella në Shqipëri, përgatitja e literaturave të duhura në gjuhën shqipe, trajnimet e mësuesve me aftësitë e duhura për këto aftësi. Kjo do të sjellë përgatitje të të rinjve me kompetencat e duhura digjitale, sepse kemi shumë fëmijë e të rinj në Shqipëri, të cilët mund të mbajnë në dorë teknologjitë më të fundit, por këto teknologji i përdorin vetëm për foto apo mediat sociale.

Gjithashtu, të fillojë sa më shpejt puna nga ekspertët për përgatitjen e politikave të duhura për inteligjencën artificiale, robotikën dhe sigurinë digjitale.

Cilat janë projektet/planet tuaj në Albanian ICT Academy?

Albanian ICT Academy

është dalluar si pionere e projekteve inovative në edukim për teknologjinë e informacionit. Lista e projekteve është shumë e gjatë. Me zhvillimin e teknologjisë dhe ne rritemi e zhvillohemi përditë dhe më shumë.

Ne kemi zhvilluar për herë të parë përpara rreth 10 vitesh kurrikulat e avancuara për fëmijë në fushën e ICT (Kodim Robotikë, Teknologjitë 3D, cybersecurity, etj) dhe kurset profesionale "Ready to Work" për të gjithë të rinjtë e profesionistët, ku 80% e pjesëmarrësve që ndjekin këto kurse arrijnë të punësohen në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar.

Listojmë shumë projekte, por po përmend disa më shumë vlerë: NASA Space Apps Challenge, ku çdo vit rreth 50 të rinjtë nga Shqipëria janë pjesë e kësaj maratone globale me rreth 50000. Për herë të parë sjellë nga Komisioni Europian, zhvillohet Albania CodeWeek Hackathon, në kuadër të maratonës EU CodeWeek, ku nga 50 shtete janë përzgjedhur vetëm 6 shtete, si pjesë e Hackathon, në mesin e tyre dhe Shqipëria. Javën e parë të Nëntorit do të jemi në Slloveni me përfaqësimin e të rinjve në BOI- Olimpiadën Ballkanike të Informatikës dhe njëkohësisht në Maqedoni me JBOI- Olimpiada Ballkanike e Informatikës për Fëmijë dhe vitin e ardhshëm përfaqësojmë Olimpiadën Ndërkombëtare të Informatikës, e cila mbahehet në Egjipt. Gjithashtu, jemi pjesë e ROES – Shoqatës Europiane të Robotikës, ku do të përfaqësohemi në vitin e ardhshëm në maratonën e Robotikës Junior.

Fokus të veçantë kemi për "Vajzat në ICT dhe STEM", të cilat trajtohen çdo vit me një mbështetje të veçantë, duke u zhvilluar sa më shumë si profesionistë në këtë fushë.

Nuk heqim dorë nga teknologjitë e reja dhe jemi duke punuar me një projekt për inteligjencën artificiale.

BIODIVERSITET

Nga qukapikët tek dallëndyshja faqebardhë, ekosistemi i pasur i Rezervatit natyror të Velipojës

Rezervati natyror i Velipojës është pjesë e zonës së mbrojtur të lumit Buna.

Rezervati natyror i Velipojës është një pikë tërheqëse për kryesisht për turistët e huaj, në mënyrë të veçantë për shumëllojshmërinë e shpendëve që gjen në të.

Prania e qukapikëve, është e zakonshme, dhe jo pak, por aty mund të gjejmë rreth 6 lloje.

Në këtë rezervat ka edhe një shpend shumë të veçantë, dallëndyshja e detit faqebardhë.

Një grup gazetarësh, studentësh dhe ekspertësh mjedisorë vizituan këtë rezervat në kuadër të trajnimit mbi gazetarinë klimatike me temë, "Eksplorimi i Ndikimeve të Ndryshimeve Klimatike në lumin Buna, Shqipëri", organizuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me GIZ Albania në Shkodër, vizituan këtë rezervat natyror, i cili ka një

ekosistem mjaft të pasur.

Gazetarëve iu bashkua edhe ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Mirela Kumbaro, e cila apeloj për ngritjen e zërit nga mediet për më shumë shkrime mbi problematikat e ndryshimeve klimatike.

Sipas saj, nevojitet që njerëzit të njohin rreziqet që vijnë nga ndryshimet e klimës në mënyrë që të gjithë së bashku të mbrojmë dhe të kujdesemi sa më shumë për mjedisin që na rrethon.

Aurora Piroviq, drejtuese e organizatës mjedisore "Well Point" në Shkodër, shpjegoi se, në këtë rezervat përfshihen rreth 4 kënetat që ndikojnë, jo vetëm për bimësinë, por kanë krijuar habitate për shumë shpendë.

"Ky ekosistem është i veçantë

për shkak të biodiversitetit të lartë, afërsia me detin dhe lumin Buna, territor i përshtatshëm për shpendët ujorë. Kur vizitojmë këtë rezervat, hasim edhe prezencë të qukapikëve", tha ajo.

Piroviq u shpreh se, në këtë rezervat ka edhe një shpend shumë të veçantë, Dallëndyshja e detit faqebardhë.

"Është shpend migrator, shfaqet kur del zambaku i bardhë i ujit në derdhje të lumit Buna. Ngjyrat e puplat të këtij shpendi janë të zeza, gri e errët ndërsa pjesa e faqeve është tërësisht e bardhë", u shpreh Piroviq.

"Në këtë zonë të mbrojtur mbizotërojnë pisha dhe plepat, jo natyrorë. Një veçori është se është e pasur me bimësi dhe faunë. Janë mbi 170 lloje të

ndryshme shpendësh, por edhe gjitarë", tha ajo.

"Dikur para 30 viteve lejohej gjuetia, pasi ka pasur edhe rezidenca qeveritare. Ky pyll është pjesë e zonës së mbrojtur të lumit Buna", tha Piroviq.

"Peizazhi Natyror i Mbrojtur i Lumit Buna është një pyll me një sipërfaqe prej 638 hektarë dhe përfshin brenda kësaj sipërfaqeje 4 kënetat shumë të rëndësishme, të cilat jo vetëm ndikojnë në llojin e bimësisë, por edhe janë habitate për shumë shpendë. Është një pyll shumë i veçantë edhe për shkak të shumëllojshmërisë së shpendëve. Por ajo që është me të veçantë është se kur vizitojmë këtë rezervat me turistë, hasim shumë lloje qukapikësh. Kur vijnë turistët, që

janë të interesuar për të parë shpendë, e kur më pyesin për qukapikë, gjithmonë i sjell këtu, sepse këtu mund të shikosh 6 lloje qukapikësh", u shpreh biologja Aurora Piroviq.

Ndikimet e ndryshimeve klimatike janë hasur edhe në këtë rezervat natyror. Është vërejtur që me ndryshimin e temperaturave, periudhat e emigrimit të zogjve migratorë kanë ndryshuar. Ndryshimi i temperaturave ka bërë që edhe sëmudjet e shpendëve të jenë rritur vitet e fundit.

Trajnimi mbi Gazetarinë Klimatike synon të nxisë një rrjet gazetarësh dhe jo vetëm, për të njohur më mirë dhe inkurajuar raportimin e çështjeve të lidhura me klimën.

Përgjatë këtij trajnimi pjesëmarrësit pritet të realizojnë publikime mbi ndryshimet klimatike, me perspektiva të reja dhe me fokus në zgjidhjen e problematikave si dhe të japin ide novatore në raportimin e klimës, duke përfshirë përvojat e realitetit virtual, podkastet, fushatat e mediave sociale ose metoda të tjera inovative të komunikimit klimatik, që mund t'i bëjnë të dhënat klimatike tërheqëse dhe të kuptueshme.

Vendi ynë është shumë i ekspozuar dhe vulnerabel ndaj ndryshimeve klimatike dhe për t'iu përgjigjur nevojave në këtë drejtim, projekti i financuar nga Fondi i Gjellbër për Klimën GCF për të forcuar gatishmërinë e Autoritetit Kombëtar të Përcaktuar NDA, po zbatohet nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Qeveria Gjermane nëpërmjet GIZ.

KËNDI I MBROJTJES INTELEGJENTE TË BIMËVE

Artikulli i Parë:

Shënim: Në këtë rubrikë do t'i ofromë specialistëve dhe fermerëve një paketë artikujsh, të cilat do të botohen në gazetën "AGROBIZNESI" në numrat e saj në vazhdim.

Mbrojtja e integruar e bimëve, strategjia më e suksesshme dhe më afatgjatë

Prof. Ass. Enver Isufi, Agronom në Mbrojtjen e Bimëve dhe Bujqësinë Biologjike



Ekologjisë.

Disa nga këto masat, ose praktikat, të cilat zbatohen në mbrojtjen e bimëve janë:

1. Praktikrat parandaluese:

Këtu futen praktikrat agronomike parandaluese si qarkullimi bujqësorë, kultivarët rezistent, plehërimi i barazpeshuar, higjiena e mjedisit bujqësorë, mjetet mekanike parandaluese etj.

2. Mbrojtja me Produkte të Mbrojtjes së Bimëve (PMB), e cila quhet edhe mbrojtja kimike e mbrojtjes së bimëve. Kjo metodë përdor insekticide për vrasjen e insekteve, fungicide për vrasjen e sëmundjeve, herbicide për vrasjen e barërave të egra. Me veti antiparaziare janë edhe mikroorganizmat,

me origjinë bakteriale, kërpudhore, virusale. Të gjithë bashkë ky grup i fundit quhet "Biopreparate"

3. Mbrojtja parandaluese me masa karantinore. Masat të cilat nuk lejojnë që të futen në territorin e vendit tonë ato parazitë që ose janë me rrezikshmëri të lartë për bujqësinë tonë, ose janë parazitë që nuk janë hasur në territorin tonë dhe duhet parandaluar futjen e tyre. Pikat e kontrollit kufitar janë më rëndësi ekonomike.

4. Mbrojtja me masa gjenezike, duke prodhuar dhe future në fermat tona kultivarë rezistent ose tolerant ndaj sëmundjeve kryesore të bimëve. Kjo masë mbrojtëse kufizon shumë mbrojtjen kimike të bimëve.

5. Mbrojtja legjislativë, e cila bazohet në ligjet dhe rregulloret të cilat parandalojnë futjen e parazitëve nga një zonë në një tjetër të vendit, ose rregullat për certifikimin e farërave dhe fidanave të pastër nga parazitët. Ligji i mbrojtjes së bimëve është në mbrojtje të territorit shqiptarë nga parazitët e rrezikshëm dhe në mbrojtjen e mjedisit duke detyruar përdoruesit të menaxhojnë e kimikate me kritere shkencore.

6. Masat mekanike. Kur

krijojmë mjete pengues të insekteve që ato të mos futen në mjedisin ku rriten bimët. Të tilla janë edhe rrjetat që mbulojnë serra.

7. Metoda termike. Përdor temperaturat e larta në disinfektimin e farërave dhe fidanave, ose edhe tokës me avuj të nxehtë. Në këto masa futet edhe diellëzimi i tokës së serrave. Toka pas vjeljeve të fundit toka punohet, ujitet dhe pastaj mbulohet me plasmë të hollë. Në plasmë në muajt korrik dhe gusht, temperatura e tokës arrinë në kufijtë 50-60 gradë celcius. Në këto temperatura vriten nematodat, dëmtues të tokës, kërpudha parazitare dhe disa nga farërat e barërave të egra.

8. Metoda bioteknike. Kjo metodë bazohet në përdorimin e feromoneve. Feromonet mund të përdorin në dy forma; si çorientues të çiftëzimit mes çifteve të insekteve dhe si dyti duke i kapur në masë insektet e dëmshëm, duke paksuar popullatën e insekteve të dëmshëm në mjedisin ku rriten bimët, kjo sinë serra dhe në fushat e prodhimit.

9. Metodrat e grackave ushqimore. Ka disa substanca ushqimore, të cilat tërheqin në

masë popullatat e insekteve të dëmshme.

10. Metodrat e kapjes në masë të insekteve me burime drite. Kjo metoda ka shumë frutëshmeri, ndaj atyre, të cilat quhen insekte të natës, sepse këto insekte tërhiqen nga burimet e dritës.

11. Mbrojtja Biologjike:

Mbrojtja biologjike përdor disa grupe organizmash dhe mikroorganizmash.

1. Insektet e dobishme. Quhen kështu sepse prodhuesve të produkteve bujqësore u sjellin dobi, për faktin se ata ushqehen me dëmtues të dëmshëm në bujqësi, duke na lehtësuar në koston e mbrojtjes së bimëve dhe kufizimin e ndotjes së mjedisit nga mbetjet kimike.

Insektet e dobishme për nga mënyra e tërheqjes, ndahen në dy grupe të mëdha.

- Grupi i parë ushqehet mbi insektet e dëmshëm si grabitqarë, domethënë që e rrëmbejnë prenjë, insektin e dëmshëm, pra e konsumon atë direkt, ashtu siç konsumon dhelpra ose shqiponja një shpend, ujku një dele, macja një mi.

- Grupi i dytë i insekteve të dobishëm është grupi i quajtur

parazitare.

Ky grup i madh insektesh të dobishëm quhet i tillë, sepse këto parazitare lëshojnë vezët në trupin e insekteve të dëmshëm. Nga vezët dalin larvat, të cilat ushqehen me organet e brendshme të insektit të dëmshëm duke e çuar atë në ngordhje.

Lidhur me llojin se si përdoren këto insekte të dobishme përdoren dy rrugë të mëdha.

Rruga e parë, është përdorimi i popullatave të insekteve të dobishme, të cilat rriten në natyrë në mjediset bujqësore dhe jasht tij. Ky grup kërkon një kujdes që të mos e vrasim ata me produktet e mbrojtjes së bimëve (PMB), të cilat janë kimikate helmuese.

Rruga e dytë, është prodhimi i popullatave të insekteve të dobishme, të rritura në të ashtëquajturat "biofabrika" nësasi shumë të mëdha individësh, të cilët prej këtu lëshohen në mjediset bujqësore, si në serra, ashtu edhe në fushat e prodhimit bujqësorë.


Çfarë duhet të dimë rreth një insekti të dobishëm?

Duhet njohur se mbi cilët insekte të dëmshëm ushqehet insekti dobishëm

Duhet njohur mënyra e jetës së insektit të dobishëm

Duhet të njihet mënyra se si ushqehet insekti i dobishëm mbi insektet e dëmshëm.

Duhet ditur se në cilën fazë të zhvillimit të insektit të dëmshëm, duhet të sillen insekti i dobishëm në parcelën e mbjellë.



"KËNDI I POEZISË SË BLERTË"

Gazeta "Agrobiznesi", ka nisur botimin e një rubrikë të re nën logon "Këndi i poezisë së blertë".

Kjo rubrikë vjen e ideuar nga profesori i njohur, Enver Isufi, pasioni dhe lidhja e të cilit me bujqësinë, prevalon në çdo drejtim duke përfshirë edhe poezinë.

Enver Isufi, profesori i nderuar, një nga emrat më të njohur të ekspertëve që kontribuon fort, veçanërisht në zhvillimin e bujqësisë organike në Shqipëri, ka botuar një libër me mbi 300 poezi, shumë nga të cilat bazohen tek natyra, mjedisi, prodhimi, biodiversiteti, që i shkojnë përshtat gazetës "Agrobiznesi".

Me autor Enver Isufin, në disa numra të gazetës Agrobiznesi, nën "Këndin e poezisë së blertë", do të botohen 2-3 vjersha dhe një përshkrim i shkurtër i një personaliteti të bujqësisë.

"Këndi i poezisë së blertë", do të jetë një ftesë e hapur edhe për shumë aktorë të linjës, gazetarë dhe ekspertë që merren me bujqësi dhe kontribuojnë në zhvillimin rural, por që puna e tyre e vyer i inspiron për të shkruar për bujqësinë edhe në zhanrin letrar siç është poezia apo proza.

Dëshirojmë që "Këndi i poezisë së blertë", të jetë një vlerë e shtuar në misionin e gazetës "Agrobiznesi", teksa "Poezia është kur emocioni ka gjetur mendimin dhe mendimi ka gjetur fjalët"

Enver Isufi

Personalitetet e Bujqësisë

AHMET OSJA

(Agronom me njohuri multi disiplinore. Ndrroi jetë vitin 2020, në moshën 84 vjeçare)

Ahmeti, ky shkencëtarë

Mbante pranë

Mikroskopin edhe belin

Nuk u lodh gjithë jetën

Të bëjë punëtoe edhe dembelin.

